

RAPORTI I KONFERENCËS

# REPARACIONET PËR DHUNËN SEKSUALE TË SHKAKTUAR GJATË KONFLIKTIT: MËSIMET NGA BALLKANI PERËNDIMOR



# MIRËNJOHJE:

Ky botim është bërë i mundur me kontributin e shumë individëve, duke përfshirë prezantuesit dhe pjesëmarrësit në e konferencës dy-ditore mbi reparacionet për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale në gjatë konfliktit (DhSGJK-së). Konferenca është mbajtur më 8 dhe 9 qershor 2016 në Jahorina-Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe u organizua nga UN Women, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe zyra e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM ) në Bosnjë dhe Hercegovinë. Mirënjohje të veçantë për kolegët dhe partnerët e listuar si më poshtë, të cilët kontribuuan me komentet thelbësore për projektin: Aida Skenderagić (IOM), Alison Davidian (UN Women, HQ), Amna Muharemović (UN Women, BeH), Flora Macula (UN Women, Kosovë), Gordana Zemunović (IOM), Igor Cvetkovski (IOM), Jasmina Papa Stubbs (UNDP), Jelena Milovanović (UN Women, Serbi), Klaudia Kuljuh (IOM), Lejla Mamut (UN Women, BeH), Margherita Vismara (UNDP), Megan Manion (UN Women, HQ), Milana Rikanovic (UN Women, Serbi), Nita Gojani (UN Women, Kosovë), Prakirti Nangia (UN Women, HQ), Rejla Radosavljev (Qendra për të Drejtën Humanitare, Serbi), Ruben Brouwer (OHCHR), Sabine Frazier (UN Women, Zyra Rajonale e Evropës dhe Azisë Qendrore), Siobhan Hobbs (UN Women, Kosovë), Viktorija Ruzičić Tokić (UN Women, BeH). Duke iu falënderuar anëtarëve, shumë të vlerësuar, të panelit që prezantuan në konferencë dhe në mënyrë të posaçme duke iu falënderuar të gjithë ata/ato që ishin të pranishëm dhe treguan historitë e tyre.

Pikëpamjet, analizat dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë pikëpamje të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, OKB-së ose ndonjë organizate të saj.

Autor: Natasha Lamoreux (UN Women)

Redaktor: Leigh Pasqual

Dizajni: Krenar Basha

Shtypi: NIGHT design

©2017 UN Women

Të gjitha të drejtat e rezervuara

RAPORTI I KONFERENCËS

# REPARACIONET PËR DHUNËN SEKSUALE TË SHKAKTUAR GJATË KONFLIKTIT: MËSIMET NGA BALLKANI PERËNDIMOR



UN WOMEN  
Jahorina-Sarajevë, 2016



# PËRMBAJTJE

---

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>6</b>
Historiku dhe konteksti	8
Programe të ndryshme të dëmshpërblimeve: prioritetet dhe analizat	9
Parimet udhëzuese	11
<b>BALLKANI PERËNDIMOR SI NJË LABORATOR PËR REPARACIONE/DËMSHPËRBLIME</b>	<b>21</b>
Praktikat e mira për reparacionet	21
Ligjet mbi reparacionet për DhSNK në Ballkanin Perëndimor	22
Sfidat me dëmshpërblimet	32
<b>MËNYRAT E REJA TË TË MENDUARIT RRETH REPARACIONEVE: REKOMANDIME PËR AKTORËT KRYESORË</b>	<b>34</b>
Gjatë hartimit të programeve të reparacioneve të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe hartimit të legjislacionit përkatës ndaj çështjeve gjinore	35
De-stigmatizimi i viktimave të DhSGJK në komunitete	35
Angazhimi i Shoqërisë Civile duke përfshirë punonjësit shëndetësorë, mediet etj.	36
Rivendosja e Agjencisë së të mbijetuarve	36
Adresimi i nevojave të shumëfishta të të mbijetuarve	36
Zhvillimi i qasjeve rajonale	37
Krijimi i bazës së provave për drejtësinë	37
<b>KONKLuzioni</b>	<b>38</b>
<b>PËRFUNDIM</b>	<b>38</b>

---

# AKRONIMET DHE SHKURTESAT

BeH	Bosnja dhe Hercegovina
ÇMI	Çarmatimi, demobilizimi dhe riintegrimi
DhBGj	Dhuna me bazë gjinore
DhKG	Dhuna kundër grave
DhSBGj	Dhuna seksuale dhe dhuna në baza gjinore
DhSGjK	Dhuna seksuale gjatë konfliktit
DhS	Dhuna seksuale
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
GPS	Gratë, paqja dhe siguria
IPZhBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OJQ-N	Organizatat joqeveritare ndërkombëtare
OJQ	Organizatë/at joqeveritare
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
RS	Republika Serbe
RSFJ	Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë
RSS	Reforma e sektorit të sigurisë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
USP	Udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm për Reparacionet për Dhunën seksuale gjatë konfliktit

# HYRJE

Dhuna seksuale është e rrënjosur tek diskriminimi me bazë gjinore. Bazuar në rolet stereotipike seksuale, dhuna seksuale përdoret për të nënshtruar dhe poshtëruar viktimat që i nënshtrohen kësaj dhune. Damka e lidhur me dhunën seksuale, i ndërlidhur edhe me diskriminimin ekzistues të bazuar në gjini, i ekspozon viktimat ndaj një pafuqie të përjetshme dhe marginalizimit. Gjatë konfliktit, dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini<sup>1</sup> shpesh është përdorur si një armë luftime. Gratë dhe burrat që mbijetojnë efektet e menjëhershme të kësaj dhune luftojnë me trauma afatgjate, pasiguri, pafuqi ekonomike dhe sociale, si dhe me sfida të shumta për të fituar drejtësinë dhe një mjet juridik efektiv, si një të drejtë të tyre të pamohueshme. Në situata të tilla, të mbijetuarit<sup>2</sup> e kanë të vështirë, ose janë penguar, të rilidhen apo vendosin raporte normale me familjen e tyre, miqtë dhe komuniteteve.

Pengesat shtesë me të cilat përballen të mbijetuarat/it në realizimin e të drejtave të tyre juridike, ushqejnë një cikël vicioz të papranueshmërisë sociale. Reparacionet kanë potencial për të thyer atë cikël dhe për të ndihmuar të mbijetuarat/it për të kapërcyer efektin e pabarazisë dhe diskriminimit. Reparacionet mund të ndihmojnë në trajtimin e pasojave të dhunës seksuale në jetën e të mbijetuarave/ëve, të rikthejnë dinjitetin e tyre dhe të ndihmojnë në eliminimin dhe shfarosjen e modeleve, thellë të rrënjosura, të diskriminimit gjinor.

Disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) theksojnë domosdoshmërinë për të mbrojtur të gjithë njerëzit që jetojnë në zonat e prekura nga konflikti nga dhuna seksuale dhe për të ofruar mbështetje dhe reparacione për të mbijetuarit/at.<sup>3</sup> Thirrja për veprim në lidhje me këto rezoluta të Këshillit të Sigurimit është e vendosur në Udhëzimin e vitit 2014 të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Reparacionet për Dhunën Seksuale gjatë Konfliktit<sup>4</sup> (USP), i cili paraqet rekomandime të forta për zhvillimin e reparacioneve për të mbijetuarat/it. Në raportin e tij të vitit 2016 për GPS në Këshillin të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së zt. Ban Ki Moon ka kumtuar rastet në të cilat, dispozitat për reparacionet janë

përfshirë në marrëveshjet e paqes (Kolumbi, Mali, Myanmar dhe në Sudanin e Jugut), duke nënvizuar se dhuna e përhapur seksuale është një realitet që shkatërron shumë strukturën e shoqërisë në zonat e konfliktit dhe në zonat apo regjionet që kanë dalë nga konflikti<sup>5</sup>. Në të njëjtën kohë, zt. Ban Ki Moon iu referua raportit të tij të atëhershëm mbi dhunën seksuale gjatë konflikteve, duke sjellë në vëmendjen e Këshillit 19 situata shqetësuese dhe një listë prej 48 palëve me dyshimin e bazuar të kenë kryer ose që janë përgjegjës për format e përdhunimit dhe format e tjera të dhunës seksuale në situata të konfliktit të armatosur.

Dhuna seksuale gjatë konfliktit (DhSK) është një murtajë e vazhdueshme që mbetet e pranishme në shumicën e konflikteve. Gjithnjë e më shumë, ajo është bërë si armë luftime, si një taktikë e një ekstremizmi të dhunshëm. Tani, në mbarë botën, është mirë e njohur se dhuna seksuale gjatë konfliktit mund të përbëjë një krim luftime, një krim kundër njerëzimit, ose një akt gjenocidi. Ky realitet i zyrtarë nënvizon rëndësinë e veprimit jo vetëm për të parandaluar dhunën seksuale, por edhe për të zbatuar programe të reparacioneve që i shërbejnë të mbijetuarave/ëve, familjeve dhe komuniteteve të tyre, siç përcaktohet në Udhëzimin e SPKB-së.

1 Dhuna me bazë gjinore përfshin çdo veprim të dëmshëm të drejtuar kundër individëve ose grupeve të individëve në bazë të gjinisë së tyre. Mund të përfshijë dhunën seksuale, dhunën në familje, trafikimin, martesën e detyruar/të hershme dhe praktikën e dëmshme tradicionale.

2 Gjatë këtij raporti, termi 'i/e mbijetuar' në të shumtën është përdorur për t'iu referuar grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë seksuale në konflikt. I/e mbijetuarat/i është termi i preferuar për viktimat ose etiketat e tjera, të cilat mund të jenë disavantazh për të mbijetuarit dhe që nuk pasqyrojnë saktësisht pozicionin dhe fuqinë që ata që kanë përjetuar dhunën seksuale në luftë shpesh mendojnë se kanë arritur.

3 Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1820 (2008), 1888 (2009), 1960 (2010), dhe 2106 (2013) merren në mënyrë eksplicite me dhunën seksuale gjatë konflikteve.

4 Kombet e Bashkuara (2014). Udhëzimi i Sekretarit të Përgjithshëm: Reparacionet për Dhunën Seksuale gjatë Konfliktit, qershor. Në dispozicion në: <http://www.ohchr.org/Documents/Press/GuidanceNoteReparationsJune-2014.pdf>

5 Kombet e Bashkuara (2016). Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën seksuale në konflikt, S / 2016/361, 20 prill. Në dispozicion nga: [https://unama.unmissions.org/sites/default/files/20042016\\_report\\_of\\_the\\_secretary-general\\_on\\_conflict-related\\_sexual\\_violence.pdf](https://unama.unmissions.org/sites/default/files/20042016_report_of_the_secretary-general_on_conflict-related_sexual_violence.pdf)

Dhuna seksuale u përdor në mënyrë sistematike në konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi. Vetëm dy dekada më vonë, qeveritë e rajonit, së bashku me organizatat e shoqërisë civile dhe të mbijetuarat/it, po bëjnë përpjekje gjithëpërfshirëse për të zbatuar programe të plota dhe komplete të reparacioneve. Për dy dekada, organizatat e grave, grupet me bazë në komunitet si dhe vetë të mbijetuarat/it kanë punuar shumë për të krijuar mekanizma mbështetës për të mbijetuarat/it dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre në mekanizmat e drejtësisë në nivel vendi, nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar. Së fundi, qeveritë kanë filluar të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për të siguruar mjete efektive juridike, duke përfshirë reparacionet për të mbijetuarat/it, siç janë mbështetja financiare, pagat mujore, qasja në shërbimet shëndetësore dhe asistencë sociale.

Edhe para ndërprerjes së dhunës në vitet 1990-ta, aktorët dhe profesionistët e shoqërisë civile, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, psikologët dhe avokatët, ishin 'reaguesit e parë' që ofruan lehtësim dhe ndihmë të menjëhershme për të mbijetuarat/it. Kjo është shndërruar në mbështetje dhe avokim afatgjatë. Progresi i bërë për sa i përket reparacioneve në Ballkan nuk do të ishte i mundur pa punën e vazhdueshme, të përkushtuar dhe jashtëzakonisht të ditur të këtyre aktorëve kryesorë.

Përvoja e Ballkanit Perëndimor është veçanërisht e vlefshme sot për vendet e prekura nga konflikti ose ato që kanë dalë nga luftërat. Ajo ka zbuluar dobinë e zgjidhjeve të koordinuara që përfshijnë qasjet transformuese, të ndjeshme ndaj gjinive dhe të orientuara drejt të mbijetuarave/ëve, duke përfshirë drejtësinë penale; si dhe proceset komplementare që vendosin më pak barrën e provës mbi të mbijetuarat/it; Dhe kërkojnë paraqitje më pak komplekse, të gjata dhe të kushtueshme në gjykatë. Është më pak e vështirë për të mbijetuarat/it nëse dëshmia e tyre konsiderohet në mirëbesim nga një komision shqyrtues i përbërë nga ekspertë teknikë. Ata mund të japin reparacione për një standard më të vogël të provës që në mënyrë të përshtatshme e pranon dhe ndërlihet me kontekstin, realitetin dhe llojin e provave që viktimat kanë gjasa të sigurojnë dhe/ose ofrojnë në kontekste të konfliktit.

## Historiku dhe konteksti

Ky raport është rezultat i një konference dy-ditore mbi reparacionet për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale në konflikt (DhSNK). Konferenca është mbajtur më 8 dhe 9 qershor 2016 në Jahorinë afër Sarajevës, në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe është organizuar nga UN Women, Zyra e Komisionit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe zyra e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Bosnjë dhe Hercegovinë. Takimi ka shërbyer si nisma e pestë dhe përfundimtare e Udhëzimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Reparacionet për Dhunën Seksuale gjatë Konfliktëve dhe, për më tepër, ka shqyrtuar zbatimin e rekomandimeve të saj në Ballkanin Perëndimor dhe në kontekst më të gjerë rajonal.<sup>6</sup> Përfaqësuesit e shoqërisë civile, autoritetet qeveritare, ekspertët e organizatave ndërkombëtare dhe avokatët dhe të mbijetuarat/it individual kanë diskutuar sukseset e programeve të reparacioneve, pengesat, praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra.

Udhëzimi i Sekretarit të Përgjithshëm, USP, të OKB-së për Reparacionet për Dhunën Seksuale gjatë Konfliktëve (USP) u botua në qershor të vitit 2014 dhe ishte produkt i punës së përbashkët të UN Women-it dhe OHCHR të kryer që nga dhjetori 2i vitit 2010, kur dy agjencitë u ngarkuan nga Komiteti për hartimin e politikave të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të zhvilluar Udhëzimin pas kryerjes së një hartëzimi të gjerë që agjencitë e OKB-së dhe agjencitë dhe mekanizmat ishin duke bërë në këtë fushë. USP të OKB-së ofron politika dhe udhëzime vepruese për angazhimin e OKB-së në ofrimin e reparacioneve për të mbijetuarat/it e DhSGJK, duke përfshirë aktivitetet për të avokuar dhe/ose mbështetur projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të reparacioneve. USP ka për qëllim të plotësojë mjetet dhe mekanizmat si dhe Udhëzimet e tjera të Kombeve të Bashkuara për të krijuar një paketë gjithëpërfshirëse për Agjencitë e Kombeve të Bashkuara për t'u përdorur për të hartuar programe dhe për të zhvilluar korniza normative për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë konfliktëve. Udhëzimi kërkon të informojë mbi angazhimin sistematik të OKB-së, dhe ofron hollësi mbi parimet e përgjithshme që përbëjnë një praktikë të mirë për reparacione.

Udhëzimi, USP është i organizuar rreth tetë parimeve udhëzuese të cilat janë më holësisht të përshkruara më poshtë.

Megjithëse shumica e rasteve të dhunës seksuale në Ballkanin Perëndimor mund të kenë ndodhur më shumë se 20 vjet më parë, vetëm në vitet e fundit që është vendosur legjislacioni që mund të konsiderohet të jetë në përputhje me parimet e Udhëzimit të Sekretarit të Përgjithshëm—duke përfshirë edhe qasjen më të mirë të të mbijetuarave/ëve në drejtësi dhe lejimin e dëmshpërblimit të disa prej dëmeve më të ashpra ekonomike dhe sociale. Disa nga këto avancime përfshijnë:

- Në Kroaci, në vitin 2015 u miratua një ligj për të drejtat e të mbijetuarave/ëve të dhunës seksuale gjatë konfliktit të armatosur, i cili përfshin një dispozitë për pagesën e kompensimit për të mbijetuarat/it.
- Në Kosovë, në vitin 2016 u miratua një ligj (me legjislacionin zbatues), i cili njeh dhe siguron përfitime për të mbijetuarat/at e dhunës seksuale gjatë konfliktit. Tani po punohet për të krijuar një komision për të shqyrtuar pretendimet e të mbijetuarave/ëve.
- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, kohëve të fundit, ka pasur dy fitore në gjykata me vendime kundër ish ushtarëve për përdhunim, duke i dënua kryesisht me burg dhe duke i kompensuar të mbijetuarat/it. Përveç kësaj, autoritetet në BH kanë njohur nevojën për të ndërmarrë një qasje sistematike për reparacionet dhe legjislacioni në Federatën e BH-së ka ndryshuar dhe është bërë më i favorshëm për të mbijetuarat/it.
- Në distriktin e Brçko-së në Bosnje dhe Hercegovinë, së fundit ka ndodhur një ndryshim i Vendimit mbi Viktimat civile të luftës në distriktin e Brçko-së, i cili eliminoi kushtin e marrjes së vendimit përfundimtar penal kundër kryerësit si dëshmi kryesore në marrjen e statusit të viktimës dhe/apo të mbijetuarës/it.
- Në Republikën Serbe në BH, një ligj i ri në hartim e sipër që mbulon viktimat e torturës, për herë të parë, do të përfshijë edhe të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë konfliktit.
- Në Serbi, ndërsa ligji origjinal mbi të drejtat e invalidëve civilë të luftës—i cili ende nuk i njeh, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategoritë e të mbijetuarave/ëve të dhunës seksuale gjatë konfliktit—ende ekziston, ka lëvizje drejt ndryshimit të dispozitës së nevojshme për t'u siguruar të mbijetuarave/ëve të dhunës seksuale gjatë konfliktit me reparacion ligjor.

<sup>6</sup> Lansimi i parë ishte në Londër, pasuar nga New York, Guatemala, dhe në fillim të qershorit 2016, Tunizi



Ky raport ofron një skicë bazë të mekanizmave ekzistues të reparacioneve në rajon në vitin 2016. Raporti synon të shërbejë si burim për personat që punojnë në këtë çështje në kontekste të tjera të konfliktit, duke përfshirë Ukrainën, Turqinë dhe Qipron (disa pjesëmarrës të këtyre vendeve morën pjesë në konferencë) si dhe rajone të tjera gjithandej në botë. Konferenca ishte një mundësi e fuqishme për praktikuesit dhe disa të mbijetuar/a për të ndarë përvojat, për të shkëmbyer informacion dhe për të bashkërenduar idetë dhe praktikat e mira rreth sukseseve dhe sfidave të tyre në rrugën e gjatë për të siguruar reparacione. Kishte shumë diskutime se si mund të dizajnoheshin më mirë reparacionet.<sup>7</sup>

Pjesëmarrësit përgjithësisht ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ministrive dhe agjencive qeveritare nga Bosnja dhe Hercegovina<sup>8</sup>, Kroacia, Kosova<sup>9</sup>, dhe Serbia. Gjithashtu morën pjesë përfaqësues nga Qiproja, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Ukraina, si dhe ekspertë nga Zyra Qendrore e Kombeve të Bashkuara, Zyra Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore (ECA) dhe përfaqësues të zyrave në terren të, UNDP-së, IOM-it, UNFPA-së dhe zyra qendrore dhe ato rajonale të OHCHR-së.

## Programet e ndryshme të reparacioneve: Prioritetet dhe analizat

Reparacionet janë masa që synojnë të "riparojnë" ose të korrigjojnë shkeljet e së kaluarës, në veçanti shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut që zakonisht lidhen me periudhat e konfliktit apo represionit (këto përfshijnë shkeljet e rënda të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe të së drejtës humanitare, në krahasim me shkeljet sporadike që gjithashtu kanë ndodhur edhe më herët, gjatë dhe pas konfliktit). Reparacionet, të cilat sigurojnë masa për drejtësi, burime për rimëkëmbje dhe një porosi të qartë të barazisë, janë mjetet më të zhvilluara për përqendrimin e viktimave. Megjithatë, këto mjete janë gjithashtu më së paku të mbështetura financiarisht.

Udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm thekson qëllimin transformues dhe potencialin e programeve të reparacioneve dhe nevojën për reparacione, duke përfshirë modalitetet e tyre, të jenë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe pjesëmarrjen e të mbijetuarve/ave është thelbësore për të siguruar që përfitimet

janë të arritshme, të barabarta dhe efektive; dhe se kriteret dhe procedurat për qasjen dhe administrimin e reparacioneve duhet të jenë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore. Reparacionet duhet të hartohen duke marrë parasysh natyrën specifike të dëmit të përjetuar nga të mbijetuarat/it, përfshirë stigmatizimin dhe përjashtimin social. Në përpjekje për të qenë transformuese, reparacionet, aty ku është e mundur, duhet të ndihmojnë në tejkalimin e pabarazisë sistematike dhe diskriminimit.

Shtetet kanë përgjegjësi ligjore, sipas ligjit ndërkombëtar, për të siguruar një mjet juridik dhe reparacione për të mbijetuarat/it. E drejta ndërkombëtare përcakton modalitete të ndryshme të dëmshpërblimeve për të riparuar dëmin dhe padrejtësinë e shkaktuar ndaj të mbijetuarave/ëve. Këto përfshijnë: kthimin, kompensimin, kënaqësinë, rehabilitimin dhe garancitë e mos përsëritjes. Këto forma të reparacioneve kanë ndikime dhe objektiva të dallueshme dhe mund të ndikojnë mënyrën e ndarjes së mjeteve nga programet e reparacioneve për të mbijetuarat/it. Gjithashtu, shpesh, ekzistojnë arsye legjitime pse disa të mbijetuar/a mund të dëshirojnë të zgjedhin privilegjon mbi një formë të caktuar të reparacionit ndaj të tjerave. Programet gjithëpërfshirëse të cilat kombinojnë përfitime individuale, kolektive, materiale dhe simbolike mund të maksimizojnë mundësitë e korrigjimit për një numër më të madh të të mbijetuarave/ëve. Udhëzuesi i SP/OKB-së shtjellon pesë modalitetet kryesore për ofrimin e reparacioneve. Ndërsa secili prej tyre mund të sigurojë lehtësim për të mbijetuarat/it, këto modalitete janë gjithsesi, të dizajnuara për t'u përdorur në mënyrë gjithëpërfshirëse. Me fjalë të tjera, duhet të shmangim qasjen e vetvetishme dhe/apo të izoluar në llojet ose modalitetet e ndryshme të reparacioneve, por ti shohim apo tu qasemi atyre në një formë bashkëpunimi, kudo që është e mundur dhe e përshtatshme.

**Dëmshpërblimi/kthimi në gjendjen e mëhershme:** Masat e dëmshpërblimit synojnë të "rivendosin [të mbijetuarën/in] në gjendjen fillestare para se të ndodhin shkeljet e rënda ... ndaj saj/tij"<sup>10</sup> Për shembull, dëmshpërblimet në bazë të kthimit në gjendjen e mëhershme mund të përfshijnë: *Rivendosjen e lirisë, gëzimit e të drejtave të njeriut, identitetin, jetën familjare dhe shtetësinë, kthimin e vendbanimit, rikthimin në vendin e punës dhe kthimin e pronës.*

7 Që nga qershori i vitit 2016, kur u mbajt ky takim, disa anëtarë të Komisionit të ekspertëve për Viktimat e Dhunës Seksuale në Kroaci u hoqën nga postet e tyre nga qeveria e re.

8 Përfshirë përfaqësues nga Republika e Bosnjë-Hercegovinës, Republikës Serbe dhe Rajonit të Brčko-së, të gjitha rajonet autonome brenda Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

9 Të gjitha referencat për Kosovën duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

10 OHCHR (2005). Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën korrigjive dhe reparacione për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe shkeljet e rënda të Ligjit ndërkombëtar humanitar. Në dispozicion në: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx>

Për krimet e dhunës seksuale, qëllimi i rikthimit në kuptimin e kthimit të individit në status quo ante shpesh mund të jetë problematikë, pasi statusi i grave edhe para konfliktit shpesh është jo i mirë. Dhuna seksuale gjatë luftës është një produkt i pabarazive strukturore gjinore dhe formave të shumta dhe të ndërthurura të diskriminimit që ekzistonin gjatë periudhës së paqes dhe shpesh mund të jetë një zgjerim dhe përkeqësim i dhunës me bazë gjinore (DhBGj) që gratë përjetuan para shpërthimit të konfliktit. Përveç kësaj, dhuna me bazë gjinore dhe seksuale (DhBGjS) gjatë konfliktit shpesh do të vazhdojë edhe në periudhën e pasluftës, me një rritje të raportimit të përdhunimeve, dhunës në familje dhe formave të tjera të DhBGj-së. Prandaj, programet e reparacioneve të përqendruara vetëm në rikthimin e statusit të personit të dëmtuar në atë të para-konfliktit, në fakt, mund të ketë një ndikim negativ duke institucionalizuar DhBGj-në dhe dhunën ndaj grave (DhNG-në) në rrethanat e pas konfliktit.<sup>11</sup> Për të qenë të sigurt, dhuna seksuale në konflikt është kryer edhe ndaj burrave dhe djemve, prandaj reparacionet duhet të jenë të dizajnuara për të përfshirë të gjitha qëllimet e këtij lloji të dhunës. Në këtë mënyrë, gratë dhe vajzat mbeten objektiv jo-proporcionalisht i synuar për DhBGj në situata konflikti.

**Kompensimi:** Reparacionet përfshijnë dispozitën e kompensimit “për çdo dëm ekonomikisht të vlerësueshëm, sipas situatës dhe proporcionalisht me seriozitetin e shkeljes dhe rrethanave të secilit rast”<sup>12</sup>. Dëmtim i tillë përfshin: dëmin fizik ose mendor, mundësitë e humbura, dëmet materiale dhe humbjen e të ardhurave, dëmin moral, dhe koston e shërbimeve ligjore, mjekësore, psikologjike dhe sociale. Në përpjekje për të kompensuar dëmet e tilla, vëmendje duhet t’i kushtohet mos-fuqizimit të stereotipave ekzistuese dhe normave kulturore në dëm të viktimave. Për këtë arsye, është e rëndësishme të identifikohet me kujdes dëmi që më pas të rregullohet me anë të kompensimit, dhe të merret në konsideratë mënyra me të cilën kompensim riparon dëmin e pësuar nga viktimat e dhunës seksuale të gjatë konfliktit.<sup>13</sup>

**Rehabilitimi:** E drejta për rehabilitim përfshin qasje në shërbime mjekësore, psikologjike dhe sociale dhe ndihmë ligjore. Megjithatë, në rrethana të pas konfliktit, infrastruktura që

do të sigurojë qasje në këto dëmshpërblime rehabilituese shpesh mungon, shpesh duke qenë të asgjësuar apo shkatërruar gjatë luftës. Si diskutim pikat kryesore si më poshtë, infrastruktura dhe rindërtimi pas konfliktit mund të jenë fushat kritike të angazhimit me dhe për aktorët e zhvillimit. Përveç kësaj, në komunitetet që dalin nga konflikti, shpesh ka mungesë të profesionistëve të kualifikuar të cilët mund të ofrojnë shërbime mjekësore, psikologjike ose sociale. Është po aq e mundshme që shumë profesionistë ende janë në nevojë për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin për ndjeshmërinë e duhur për të ofruar shërbime për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë konfliktit në mënyrë që të evitohen të ri-traumatojnë apo damkosin ato/ata. Kjo, gjithashtu, mund të jetë një fushë e rëndësishme për angazhim me aktorët ndërkombëtarë, duke e kuptuar se bashkëpunimi dhe ndihma ndërkombëtare nuk duhet të jetë zëvendësim për rolin që Shtetet duhet të luajnë për sa i përket reparacioneve, duke përfshirë njohjen e përgjegjësisë për shkeljet dhe përdorimin e kapaciteteve të tyre financiare dhe institucionale me zell për të riparuar dëmin.

**Kënaqshmëria:** Mbulon një sërë masash, të cilat përfshijnë: ndërprerja e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve, komisionet e kërkimit të së vërtetës apo mekanizma të tjerë, kërkimet për të zhdukur, gjetjen dhe rivarrimin e eshtrave, sanksionet gjyqësore dhe administrative, falje publike dhe përkujtimin. Brenda secilës prej këtyre masave, angazhimi dhe pjesëmarrja kuptimplotë e të mbijetuarave/ëve në çdo fazë—që nga konceptimi dhe projektimi, deri te zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi—është shumë qenësore. Masat e kënaqshmërisë mund shpejt të bëhen gjeste të pakuptimta dhe madje edhe të shkaktojnë dëm apo të shkaktojnë stereotipa të dëmshëm, pa përfshirjen e atyre që ata kanë për qëllim për të shërbyer dhe një të kuptuar të drejtë të përcaktimit dhe/apo rrethanave kulturore aty ku duhet dhënë reparacionet dhe nëse ato janë në përputhje me parimet e barazisë gjinore.<sup>14</sup>

**Garancitë për mospërsëritje:** Garancitë për mospërsëritje janë ndoshta masat më të rëndësishme të reparacioneve për të mbijetuarat/it, familjet e tyre dhe për qëndrueshmërinë e paqes dhe tranzicionit. Për disa të mbijetuar/a, masat që sigurojnë

11 Kombet e Bashkuara (2015). "Raporti i Grupit Këshillues të Ekspertëve për Shqyrtimin 2015 të Arkitekturës së Ndërtimit të Paqes të Kombeve të Bashkuara", para. 54. Në dispozicion në: <http://www.un.org/en/peacebuilding/pdf/150630%20Report%20of%20the%20AGE%20on%20the%202015%20Peacebuilding%20Review%20FINAL.pdf>

12 OHCHR (2005). Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën korrigjive dhe reparacione për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe shkeljet e rënda të Ligjit ndërkombëtar humanitar. Në dispozicion në:

13 Organizata e Kombeve të Bashkuara (2014). Udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm: Reparacionet për Dhunën Seksuale Gjatë Konfliktit, qershor, f. 16. Në dispozicion në: <http://www.ohchr.org/Documents/Press/GuidanceNoteReparationsJune-2014.pdf>

14 Organizata e Kombeve të Bashkuara (2014). Udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm: Reparacionet për Dhunën Seksuale Gjatë Konfliktit, qershor, f. 18. Në dispozicion në: <http://www.ohchr.org/Documents/Press/GuidanceNoteReparationsJune-2014.pdf>

mospërsëritje të dhunës janë prioritet bile edhe para mirëqenies së tyre fizike, emocionale apo financiare, sepse kjo është një garanci që fëmijët dhe nipërit e tyre nuk do të duhet të vuajnë të njëjtat trauma në një konflikt eventualisht të përsëritur.

Këto masa mund të përfshijnë reforma për të siguruar parandalimin e abuzimeve të ardhshme, siç janë *vendosja e kontrollit civil të forcave ushtarake dhe të sigurisë, forcimi i sistemit gjyqësor të pavarur dhe sundimi i ligjit, mbrojtja e shërbimit civil dhe të drejtave të punëtorëve, reformat legislative, promovimin e përgjithshëm të standardeve të të drejtave të njeriut si dhe krijimin e mekanizmave për parandalimin dhe monitorimin e konfliktit social dhe zgjidhjen e konflikteve.*

## Parimet udhëzuese

Ne e dimë se dhuna seksuale ndodh para, gjatë dhe pas konfliktit. Nëse duam të shkojmë përtej biznesit si zakonisht, duhet të fillojmë të shikojmë format e reparacioneve nëpërmjet lenteve të transformimit dhe përmes asaj që do të thotë të fuqizojmë të mbijetuarit.

Alison Davidian

Analiste e Politikave

UN Women

Ndërsa programet e reparacioneve janë përdorur për të gjitha viktimat civile të luftës, programet e reparacioneve për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë konfliktit janë veçanërisht të rëndësishme, sepse ato mund të:

- njohin të drejtat e të mbijetuarave/ëve si qytetarë të barabartë, dhe të promovojnë përfshirje;
- ofrojnë masën e drejtësisë;
- ofrojnë burime të rëndësishme për rikuperim; dhe
- kontribuojnë në transformimin e diskriminimit dhe pabarazisë së theksuar me bazë gjinore në shoqëritë e dala prej konfliktit, veçanërisht ato që dërgojnë apo vendosin gratë të në shënjestër.

Megjithatë, pavarësisht të drejtës ligjore të njohur ndërkombëtarisht për zgjidhje efektive (duke përfshirë reparacionet), rëndësinë e reparacioneve të mbijetuarave/ëve, si dhe potencialin e tyre për të sjellë ndryshime

transformuese, deri më sot, programet e reparacioneve, shumë shpesh, kanë dështuar për të përfshirë, të reflektuar dhe për të adresuar përvojat specifike, nevojat dhe prioritetet e grave, ose për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate për dëmet specifike gjinore të pësuar gjatë periudhave të konfliktit. Hartimi, zbatimi dhe ofrimi i shërbimeve të ndjeshme gjinore ende mungon në shumë prej programeve të reparacioneve, siç është njohja e të mbijetuarve/ëve të dhunës seksuale që respekton dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Fakti që reparacionet janë nën-shfrytëzuara në masë të madhe kanë ofruar një shtysë për zhvillimin e udhëzimit të Sekretarit të Përgjithshëm (USP), dhe ka nxitur dialog të vazhdueshëm, seminare dhe konferenca duke sjellë së bashku komunitetet e të mbijetuarve/ëve, praktikuesve dhe autoriteteve për të punuar drejt një zbatimi të plotë dhe më transformues.

Udhëzimi i SP-së përqendrohen në tetë parime për dëmshpërblimet të cilat u diskutuan gjerësisht në konferencën e qershorit:

### 1. Reparacioni adekuat për viktimat e dhunës seksuale në konflikt përfshin një kombinim të formave të ndryshme të reparacioneve.

*“OKB-ja duhet të promovojë programe gjithëpërfshirëse të cilat gjithashtu mund të përfshijnë të gjitha ose disa variante të reparacioneve individuale, kolektive, simbolike dhe materiale, si dhe qasjen prioritare në shërbime. Duke pasur parasysh seriozitetin e dëmeve të shkaktuara ndaj viktimave të dhunës seksuale në konflikt, nevojitet një kombinim dhe ndërveprim i formave të ndryshme të reparacioneve. Reparacionet kanë potencial të transformohen dhe të ndihmojnë në kapërcimin e pabarazisë dhe diskriminimit.” Udhëzimi i SP-së, fq. 6.*

Dhuna seksuale në konflikt është komplekse dhe, përderisa nuk ka përkufizim të përgjithshëm të pranuar, ajo mund të përfshijë një sërë shkeljesh, përfshirë përdhunimin, sulmet seksuale, shfrytëzimin seksual, përdhunimin e simuluar, shtatzëninë e detyruar, abortin ose sterilizimin, gjymtimin gjenital, shfrytëzimin seksual, trafikimin, prostitucionin e detyruar ose lakuriqësinë dhe disa trauma të tjera fizike dhe psikologjike. Efektet afatshkurtra dhe afatgjata të mbijetesës së dhunës seksuale janë gjithashtu të ndryshme nga personi në person dhe konteksti në kontekst.

---

Të gjithë ne kemi identitete të shumëfishta. Ju nuk jeni vetëm një grua, ju mund të jeni grua që e identifikon veten si një mjek. Ju mund të keni të gjitha këto identitete të shumta në të njëjtën kohë, dhe ju zgjidhni cili/cila jeni në një moment kohor. E njëjta gjë është e vërtetë për përvojat tuaja gjatë konfliktit. Gjithkush përjeton konfliktin ndryshe, por ndikimi më i madh tek ata/ato është shumë i ngjashëm, ajo që ndodh me njerëzit, përmbajtja është pothuajse e njëjtë. Nëse ju jeni një i/e mbijetuar e DhSGJK-së, që është një identitet më vete, por ky nuk është identiteti i vetëm që ju keni. Ju mund të zhvendoseni, "spastrimi etnik", mund të keni qenë të torturuar në mënyra të tjera, ndoshta ju keni parë fëmijët tuaj duke u vrarë në sytë tuaj, ndoshta ju jeni ai/ajo i/e cila arriti të sjellë paqe në komunitetin tuaj, ndoshta ju jeni njeri/njëra me identitetin e një ndërmjetësi. Identitete të shumta, të cilat duhet të identifikohen, disa prej të cilave duhet të mbështeten.

Madeleine Rees,

Secretary General of the Women's International League for Peace and Freedom Sekretare e Përgjithshme e Grave Ligës Ndërkombëtare të Grave për Paqe dhe Liri

---

Reagimi, pra, duhet të marrë parasysh llojet e dhunës seksuale në konflikt—DhSNK-së dhe manifestimet e shumëfishta të traumës pasuese. Reparacionet duhet të përfshijnë një paketë gjithëpërfshirëse të mbështetjes dhe shërbimeve të përshtatura për kontekstin lokal dhe nevojat specifike të të dëmtuarve. Kjo duhet të përfshijë marrjen parasysh të të gjitha nevojave të të mbijetuarve (dhe anëtarëve të familjeve të tyre), në vend që thjesht të adresojë pasojat e menjëhershme dhe/apo akute të krimit. Në të vërtetë, anëtarët e familjes siç janë fëmijët ose partnerët, fëmijët e lindur si pasojë e shtatzënisë nga përdhunimi, si dhe persona të tjerë që varen nga të mbijetuarat/it mund të vuajnë gjithashtu si pasojë e dëmit të shkaktuar ndaj viktimave. Përgjigja apo reagimi duhet të përfshijë edhe personat që kanë pësuar dëm gjatë ndërhyrjes për të ndihmuar viktimat dhe të mbijetuarat/it në vështirësi ose kanë reaguar për të parandaluar viktimizimin. Pjesëmarrësit në konferencë u pajtuan se vetë të mbijetuarat/it mund të luajnë një rol kritik në hartimin e reparacioneve më të përshtatshme. Disa anëtarë të panelit kanë sugjeruar se reparacionet duhet të marrin në konsideratë se si ndikon dhuna seksuale në konflikt tek anëtarët e familjes dhe komuniteti në një periudhë afatmesme deri te afatgjatë dhe prandaj duhet të jenë të ndërtuara në atë mënyrë që të parashohin këtë element dhe të jenë përfshirëse, përveç që përmbajnë efektin transformues dhe atë të fuqizimit.

## 2. Reparacionet gjyqësore dhe/ose administrative duhet të jenë në dispozicion të viktimave të dhunës seksuale në konflikt si pjesë e të drejtës së tyre për të pasur qasje të menjëhershme, adekuate dhe efektive mjetet juridike.

"Kur shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe/ose shkeljet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë edhe dhunën seksuale në konflikt, shkaktohen në një shkallë të madhe, programet e reparacioneve administrative kanë potencial të jenë më gjithëpërfshirëse dhe më të arritshme se sa gjykatat. Këto programe janë, në fakt, të afta për të arritur një numër më të madh të viktimave dhe janë më miqësore ndaj viktimave, pasi procedurat e tyre janë më elastike dhe standardet dhe kostot e provave janë dukshëm më të ulëta. Ato nënkuptojnë njohjen e dëmit të pësuar, pa e nënshtruar atë në procedurë gjyqësore të përgjegjësive të kryerësit. Sidoqoftë, programet e reparacioneve administrative nuk duhet të parandalojnë viktimat e dhunës seksuale në konflikt për marrjen e dëmshpërblimeve përmes gjykatave; Të gjitha viktimat duhet të kenë qasje në mjete efektive gjyqësore që përfshijnë dëmshpërblim adekuat, të shpejtë dhe të plotë për dëmin e pësuar. Gjykatat vendore ose ndërkombëtare duhet të marrin parasysh dhe të plotësojnë reparacionet e dhëna nga programet e dëmshpërblimeve administrative kur vendosin për dëmshpërblimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit". Udhëzimi i SP-së, faqe 6.

---

[DhSGJK] është zgjedhur nga kryesit me qëllim të lëndimit dhe poshtëruar të të mbijetuarës/it ... dhuna seksuale shkakton pasoja afatgjatë, dhe të rënda për të mbijetuarat/it për shëndetin fizik dhe psikologjik të viktimave, marrëdhëniet familjare, funksionimin social dhe sigurisht pasoja në aftësinë e tij/saj për punë.

Të mbijetuarat/it e formave të ndryshme të traumës, duke përfshirë dhunën seksuale kanë nevojë për ne, jo vetëm profesionistë, por edhe si qenie njerëzore. Prandaj, ne kemi nevojë për të dyja profesionalizmin dhe edukimin për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate nevojave të tyre për të lehtësuar ata/ato që të realizojnë të drejtat e tyre.

Marijana Senjak

Bashkë-themeluese e Medica Zenica

---

Reparacionet gjyqësore lejojnë ndjekjen penale në gjykata penale ose gjykata civile. Për disa të mbijetuar/a, rekursat përmes gjykatave sigurojnë njohje dhe njohje sipas ligjit se është kryer një shkelje kundër tyre. Për të tjerët, megjithatë, kërkesa—ose rreziku—për të zbuluar identitetin e tyre si të mbijetuar/a dhe për t'u përballur me kriminelët apo kryesit e veprave mbi to/ta mund të jetë shumë i fortë dhe parandalues, në mënyrë që këta të mbijetuar/a të heqin dorë nga e drejta e tyre për kompensimin gjyqësor. Ekzistojnë edhe disa pengesa të tjera për reparacione gjyqësore për dhunën seksuale në konflikt.



---

Në shumicën e rasteve autori i krimit është i panjohur, madje edhe në rastet kur ata/ato janë të njohur ata nuk kanë të ardhura. Kjo është arsyeja pse Kroacia ka vënë fokusin mbi viktimën dhe jo mbi kryesin..

Visnja Misin

Komisioni vlerësues, Kroaci

---

Për shembull, në disa kontekste, vetëm të mbijetuarat/it e rasteve në të cilat që kryesit janë ndjekur penalisht për dhunën e shkaktuar seksuale mund të kenë të drejtën e reparacionit gjyqësor (lënda Lubanga<sup>15</sup> e gjykuar në Tribunalin ndërkombëtar për krime të luftës është një shembull i kësaj). Për më tepër, shumë të mbijetuar/a duhet të kapërcejnë pengesat logjistike, financiare dhe emocionale për t'i sjellë rastet në to gjykatë.

---

Të mbijetuarat/it e DhSGJK-së duhet të dëgjohen, është e pamundur që të ketë prova për procesin penal në këtë pike/fazë. Kam punuar në rishikimin e vendimeve, duke përfshirë kompensimin financiar për të mbijetuarat/it. 3 raste kanë përfshirë kompensimin financiarë gjatë procedurës penale deri më tani: një aktgjykim tani është plotësisht i zbatueshëm, i dyti është në apel, dhe aktgjykimi i tretë ndoshta do të apelohej. Në këto raste grave u është dhënë statusi i dëshmitarit të mbrojtur—një rast në të cilin të mbijetuarës/it i është dhënë kompensim dhe kryesit e krimit janë dënuar me mbi 10 vjet.

Megjithatë, në rast se kryerësit janë të panjohur nevojitet një proces administrative. Një procedurë administrative do të lejojë viktimat që të ruajnë dinjitetin e tyre.

Zvezdana Antonovic

Gjykata e BeH-së

---

Në kontekstin e Ballkanit, sikur që disa pjesëmarrës e vunë në dukje, standardet e provave dhe, në disa kontekste, statutet e kufizimeve për ndjekje paraqesin pengesa të vështira apo edhe të pakapërcyeshme. Për më tepër, siç u diskutua, në kohën kur konfliktet janë

duke u zhvilluar, ka pasur disa përpjekje zyrtare të qeverisë për të mbledhur dhe proceduar dëshmi të DhSNK-së. Në vend të kësaj, shumë nga kjo punë u udhëhoq nga organizatat e grave. Të dhënat jo të plota kanë kufizuar ndjekjet e suksesshme penale dhe procedurat civile. Në disa kontekste, barra e provës që u vendoset të mbijetuarve/ave është shumë kërkuese.

Në të njëjtën kohë, nuk ekziston vetëdije e mjaftueshme publike për ligjet dhe se si të hulumtohen proceset ligjore për t'iu qasur reparacioneve dhe dëmshpërblimeve gjyqësore. Prandaj proceset duhet të thjeshtohen, gjë kjo që mund të kërkojë legjislacion të ri ose ndarjen e burimeve të konsiderueshme për të ndihmuar të mbijetuarat/it për të realizuar të drejtat e tyre përmes gjykatave.

Së fundi, në disa kontekste ku ekzistojnë programet e reparacioneve gjyqësore, të mbijetuarit/at duhet së pari të kalojnë nëpër procedura penale për të gjetur fajtorë kryesit e veprave. Vetëm pas procesit penal ato/ata mund t'i referohen procedurave civile për të kërkuar dëmshpërblim. Kjo kërkon që të mbijetuarat/it të kalojnë nëpër dy procese gjyqësore, që mund të jenë emocionalisht traumatike, të gjata dhe financiarisht të papranueshme. Të paktën në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, të mbijetuarat/it në procedura civile humbasin gjithashtu të drejtën e tyre për të mbrojtur identitetin e tyre. Proceset administrative mund të shmangin shumë prej këtyre sfidave. Në disa vende në Ballkan, duke përfshirë Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë dhe Kosovën, komisionet e shqyrtimit janë krijuar ose janë në krijim e sipër, për të shqyrtuar kërkesat individuale dhe për t'u dhënë atyre statusin zyrtar si të mbijetuar/a të dhunës seksuale gjatë konfliktit, që më pas u lejon atyre qasje në një gamë shërbimesh.

### 3. Reparacionet individuale dhe kolektive duhet të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.

"Reparacionet mund të shpërndahen edhe individualisht edhe kolektivisht. Reparacionet kolektive mund të plotësojnë dëmshpërblimet individuale. Sidoqoftë, ato synojnë t'i shërbejnë qëllimeve të ndryshme. Si të tilla, reparacionet kolektive nuk janë zëvendësim për reparacionet individuale." Udhëzimi i SP-së, faqe 7.

Edhe reparacionet individuale edhe ato kolektive u shërbejnë qëllimeve të rëndësishme kur bëhet fjalë për ofrimin e drejtësisë, si dhe për perceptimet më të gjera mbi drejtësinë.

---

15 Më 14 mars 2012, Gjykata Ndërkombëtare Penale e gjeti mbretin e luftës kongoleze, Thomas Lubanga Dyilo fajtor për krime të luftës për regjistrimin dhe rekrutimin e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare dhe përdorimin e tyre aktiv në luftimet në RDK-ë midis shtatorit 2002 dhe gushtit 2003, për të cilat Ai më vonë mori një dënim me 14 vjet burg. Më 7 gusht 2012, në procesin e parë të reparacionit në Gjykatën Ndërkombëtare Penale, Dhoma Gjyqësore I (DhGj I) lëshoi urdhrin e saj të parë për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar si rezultat i krimeve për të cilat Lubanga ishte dënuar. Dhoma Gjyqësore ka urdhëruar që të bëhen reparacione për "nëpërmjet" Fondit të mirëbesimit për viktimat (FMV-së), si dhe për FMV-në të zhvillojë një plan zbatimi të reparacioneve, duke përfshirë grumbullimin e konsultimeve ndërkombëtare, si dhe vlerësimin e dëmeve dhe konsultimin me popullsinë e prekur. Megjithatë, aktgjykimi i mëposhtëm dhe i parë i ankesës në mars të vitit 2015 ndryshoi urdhrin për reparacione, duke konsideruar se dhuna seksuale dhe ajo me bazë gjinore nuk mund të përkufizohen si një dëm që rrjedh nga krimet për të cilat Lubanga ishte dënuar dhe për këtë arsye Lubanga nuk mund të ishte përgjegjëse për dëmshpërblimet mbi këto baza. Aktgjykim mbi ankesat kundër "Vendimit që përcakton parimet dhe procedurat që do të zbatohen për reparacionet" e datës 7 gusht 2012 me urdhër të ndryshuar (Aneksi A) (3 mars 2015) par. 196.

Reparacionet që synojnë të adresojnë shkeljet në nivel individual janë kritike për të siguruar që individët të kenë një ndjenjë të drejtësisë së ofruar, të pranojnë krimin (et) e kryera kundër tyre dhe, në njëfarë mase, të kompensojnë dhunën që kanë përjetuar. Ato gjithashtu përfshijnë masa ndëshkuese për kryesit, të cilët, në mënyrë ideale, kontribuojnë në një kulturë preventive për të parandaluar veprimet e ardhshme të DhSNK-së. Kjo mund të sigurojë një ndjenjë të kënaqësie për të mbijetuarat/it, si dhe të ndihmojë për të siguruar garancitë e mos përsëritjes.

---

"Imagjinoheni, përpara [Tribunalit] të Grave të Sarajevës që ka ndodhur, kanë qenë pesë të mbijetuar/a të cilat/ët i kanë thënë organizatës tanë "Unë dua të shkoj dhe të dëshmojë. Për mua, kjo ishte kaq e fuqishme, që ata/ato arritën në Sarajevë, ata/ato dëshmuar dhe ata/ato u kthyen në shtëpi më ndryshe. Ata/ato u kthyen prej nga kanë ardhur më ndryshe. Për shkak se ata/ato thanë: "Ne nuk e kemi parë drejtësinë ligjore, por e pamë drejtësinë alternative, dhe ne e kuptuam se nuk jemi vetëm." Sepse në Sarajevë, ata/ato u takuan me të mbijetuar/a të tjerë."

Zonja Igballe (Igo) Rogova,

Rrjeti i Grave të Kosovës

---

Në disa raste, dëmshpërblimet kolektive mund të ofrojnë një ndjenjë më të gjerë të drejtësisë ndaj komunitetet që ishin në shënjestër dhe që pësuan gjatë konfliktit, veçanërisht atë komunitet që ka përjetuar dhunë seksuale në një shkallë më të madhe.

Reparacionet kolektive duhet të shihen nga perspektiva e komunitetit më të gjerë dhe të përfshijnë mekanizma dhe procese të drejtësisë që synojnë të ndihmojnë shoqëritë të tejkalojnë dhe të rikuperohen nga shkeljet e së kaluarës për të lëvizur drejt një paqeje të qëndrueshme. Reparacionet kolektive gjithashtu mund të ndërliken me programet e zhvillimit për të rivendosur infrastrukturën, strehimin dhe objektet që janë fizikisht të shkatërruara ose të dëmtuara. Sidoqoftë, ndërsa ekzistojnë lidhje të përshtatshme me ndërhyrjet e zhvillimit pas konfliktit për të arritur qëllimet e përcaktuara në hartimin e reparacioneve kolektive, projektet e tilla duhet të mbajnë një cilësi riparuese dhe në veçanti të përfitojnë anëtarët e komunitetit si të mbijetuar/a dhe jo thjesht të synojnë të përmbushin nevojat themelore dhe urgjente si qytetarë, ose që nuk reparacione fare.<sup>16</sup>

Reparacionet kolektive gjithashtu mund të

kënaqin nevojën e një komuniteti për të zëvendësuar/ndërruar vendet ku mund të jenë kryer mizoritë, në mënyrë që ai/ato vende të mos jenë një rikujtim i vazhdueshëm i dhimbjes dhe vuajtjes që është përjetuar gjatë konfliktit. Sidoqoftë, sidomos në rastet e konfliktit etnik, gjatë hartimit të programeve kolektive të reparacioneve vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet që të sigurohet që programet e reparacioneve të mos ngrenë tensione të reja duke krijuar një ndjenjë që një komunitet meriton kompensim, ndërsa tjetri nuk meriton.

Si reparacionet individuale ashtu edhe ato kolektive janë mjete të fuqishme për drejtësi dhe këtu përsëri, ka arsye të vlefshme pse të mbijetuarat/it mund t'i japin prioritet një forme mbi tjetrën. Sidoqoftë, skemat e reparacioneve individuale dhe kolektive funksionojnë më mirë kur plotësojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën, varësisht nga konteksti dhe preferencat e të mbijetuarve/ave.

---

<sup>16</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara (2014). "Raporti i Raportuesit Special për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacioneve dhe garancive të mos përsëritjes", tetor 2014. A/69/518. Shih Parametrat Operativë 40 dhe 41. Në dispozicion në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N14/564/67/PDF/N1456467.pdf?OpenElement>

<sup>17</sup> Shih "Çfarë është Drejtësia Tranzicionale?", TPNJ. Në dispozicion në: <https://www.ictj.org/about/transitional-justice>

## BOX 1

### Ndërlidhja e reparacioneve me një politikë më të gjerë, gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale

Jo vetëm që reparacionet individuale dhe ato kolektive duhet të plotësojnë dhe të forcojnë njëra—tjetrën, skemat e reparacioneve duhet të plotësojnë dhe të forcojnë elementë të tjerë të një politike gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale,<sup>18</sup> përkatësisht çdo ndjekje penale, reformat institucionale, komisionet e së vërtetës, që një vend mund t'i ndër marrë për të adresuar krimet e së kaluarës. Për shembull, kjo do të thotë se ndjekjet penale për dhunën seksuale në konflikt, si ato që kanë ndodhur në Bosnje-Hercegovinë, duhet të lidhen me reparacionet individuale dhe kolektive transformuese. Përkujtimi duhet të jetë i lidhur ngushtë me dhe të forcojë reparacionet kolektive për grupet që kanë pësuar dëm, ndërsa mekanizmat e kërkimit të së vërtetës duhet të rekomandojnë skema të reparacioneve duke u bazuar në gjetjet e tyre...

Gjykatat e Grave ofrojnë një shembull të shkëlqyer rajonal se si mekanizmat e drejtësisë tranzicionale mund të funksionojnë. Pas konfliktit, gati dhjetëvjeçar, në Ballkanin Perëndimor, aktivistët dhe udhëheqësit e shoqërisë civile nga i gjithë rajoni panë nevojën që të mbijetuarat/it të bashkohen dhe të ndajnë historitë e tyre në formë publike apo hapur për të arritur, të paktën, një formë simbolike të njohjes së krimeve e kryera kundër tyre. Pas një kampanje të gjerë së ngritjes së vetëdijes në të gjithë vendet e ish-Jugosllavisë, nga 7 maji deri më 10 maj të vitit 2015, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të grave nga i gjithë rajoni organizuan një Gjykatë të Grave në Sarajevë. Gjatë rrjedhës së punimeve tre-ditore, mbi 30 gra dëshmuar hapur/publikisht mbi spektrin e dhunës etnike, ushtarake dhe seksuale që përjetuan dhe siguronin dhe ofruan të flasin në emër të grave të tjera viktime të dhunës së ngjashme. Në Gjykatën e Grave morën pjesë 12 ekspertë, përveç një bordi këshillues ndërkombëtar të përbërë nga përfaqësues të disa vendeve të BE-së dhe 11 gjyqtarë të cilët/cilat ofruan rekomandime dhe vënë në pah natyrën aktuale, kufizuese, të mekanizmave tradicionale të drejtësisë.

Të mbijetuarat/it nga konflikti në Kosovë gjithashtu morën pjesë në Gjykatën e Grave dhe, për shumë, përvoja ishte transformuese. Gjykata e Grave ishte një pohim i prekshëm se ato/ata nuk janë vetëm në përvojat e

tyre të dhunës seksuale ose në traumën, izolimin dhe stigmatizimin që pasoi pas dhunës së shkaktuar mbi ta/to. Gjykata gjithashtu u demonstroi pjesëmarrësve se ato/ata mund të gjejnë njëfarë drejtësie jashtë mekanizmave tradicionale, për të cilët shumë mendonin se kishin dështuar.

Suksesi i Gjykatës së Grave është në kontrast me kufizimet e institucioneve ekzistuese gjyqësore, të cilat tentojnë t'i konsiderojnë gratë në vetëm viktime. Gjykatat e grave e vlerësojnë procesin, jo vetëm gjetjet. Të përfshirët në Gjykatën e Grave theksuan se Gjykata "nuk ishte e konceptuar për t'i treguar gratë si viktime, por si luftëtare". Kjo jo vetëm që siguroi një hapësirë për të mbijetuarat gra që të bashkoheshin për të dëshmuar publikisht për përvojat e tyre të dhunës seksuale, por gjithashtu vepruan si një platformë për pjesëmarrësit për të eksploruar vazhdimësinë e dhunës dhe mënyrat në të cilat format e ndryshme të dhunës janë ndërthurur para, gjatë dhe pas konfliktit. Për shembull, të mbijetuarat/it diskutuan viktimizimin e vazhdueshëm të tyre përmes politizimit dhe keqpërdorimit të dëshmitë të tyre nga disa.

Përfundimisht, si rezultat i Gjykatës së Grave, rrjetet e grave (në të gjithë rajonin?) U forcuan dhe gratë ishin në gjendje ta kthenin tragjedinë e tyre më të thellë në veprim të përbashkët për drejtësi dhe paqe.

"[Gjykata e grave] ka një kuptim feminist të drejtësisë dhe llogaridhënies—gjykatat e grave janë duke u bërë mekanizëm dominues dhe kanë sfiduar rrëfimet dominuese rreth dhunës.."

Zonja. Stanislava Zajovic,

Gratë në të Zeza, Serbia

#### 4. Reparacionet duhet të përqipen të jene transformuese, duke përfshirë projektimin, zbatimin dhe ndikimin.

"Dhuna seksuale shpesh rezulton nga dhe vazhdon modelet e nënshtrimit dhe diskriminimit para-ekzistues për burrat dhe gratë. Për gratë, shpesh është e rrënjësor në besimin e përgjithshëm të nënshtrimit të grave dhe të drejtave seksuale të meshkujve, të kombinuara me mosrespektimin e gëzimit/ushtrimit të barabartë të të drejtave të njeriut nga gratë. Dhuna seksuale ndaj meshkujve është gjithashtu e rrënjësor në stereotipat sa i përket maskulinitetit dhe konstruktit të gjinisë dhe identitetit seksual në lidhje me pushtetin dhe dominimin. Këto pabarazi gjithashtu mund

18 Grupe të përfshira: përfshirë nënat e enklavave të Srebrenicës dhe Zepës, Forumin e Grave dhe Fondacionin CURE nga Bosnja dhe Hercegovina; Qendra për studimet e grave dhe Qendra për viktimat gra të luftës - ROSA nga Kroacia; Rrjeti i grave të Kosovës; Këshilli kombëtar për barazi gjinore nga Maqedonia; Anima nga Mali i Zi; Lobi i grave në Slloveni; Dhe Studimet mbi gratë dhe Gratë në të Zeza nga Serbia. Shih: <https://www.popularresistance.org/the-womens-court-a-feminist-approach-to-justice/>

të përkeqësojnë pasojat e krimit. Reparacionet duhet të përpiqen të kenë një efekt transformues në lidhje me këto pabarazi, në vend që të rivendosin ose forcojnë kushtet strukturore brenda shoqërisë që mbështesin praktikatat dhe besimet e tilla dhe që nxisin kryerjen e dhunës seksuale. Reparacionet kanë potencial të shkaktojnë ndryshime të rëndësishme edhe nëse ato vet nuk mund të transformojnë shkaqet rrënjësore të dhunës seksuale të lidhura me konfliktin ose kushtet strukturore që e bëjnë të mundur një dhunë të tillë." Udhëzuesi i SP-së, faqe. 8.

Një nga parimet thelbësore dhe ndër-sektoriale të përfshira në Udhëzuesin e SP-së është nevoja që reparacionet të jenë transformuese në ndikimin e tyre. Reparacionet transformuese duhet të shikojnë përtej një shkeljeje të vetme—përtej aktit diskret të dhunës seksuale—dhe të adresojnë kontekstin më të gjerë të pabarazisë që i bën gratë të pambrojtura ndaj dhunës.

---

Në pothuajse të gjitha kontekstet, të mbijetuarat/it e DhSGJK-së janë të pafuqishëm/e dhe të mënjanuar/a ... Shfuqizimi i të mbijetuarave/e të DhSGJK-së nuk përfundon edhe pas ndërprerjes së armiqësive; sepse turpi shoqëror, stigma, frika individuale, sikleti, çnderimi individualë dhe kolektiv, vazhdojnë të shfuqizojnë të mbijetuarit.

Siobhan Hobbs

Këshilltare për çështje gjinore, UN Women, Kosova

---

Me fjalë të tjera, në mënyrë që reparacionet të jenë transformuese, ato nuk duhet të konsiderojnë vetëm aktin e dhunës seksuale, por duhet të punojnë gjithashtu për të eliminuar kontekstet e pabarazisë që i bëjnë gratë më të prekshme ndaj këtij lloji të dhunës. Kjo kërkon nga hartuesit e programeve të reparacioneve për të bërë pyetje kritike dhe për të identifikuar mënyrat për të sfiduar dhe përfundimisht për të eliminuar dhe çrrënjësuar pabarazitë strukturore që rrisin cenueshmerinë e grave, në bashkëpunim të plotë me të mbijetuarit. Për të filluar eliminimin e pabarazive të tilla do të ekzistojë nevoja që programet e reparacioneve të jenë shumë më të gjera dhe më gjithëpërfshirëse sesa një pagesë në të holla. Në fund të fundit, reparacionet transformuese nënkuptojnë investime në barazinë gjinore, sepse shoqëritë ku ekziston paqja e qëndrueshme janë gjithmonë shoqëri ku burrat dhe gratë janë më të barabartë.

Duke synuar të jenë transformuese, programet e reparacioneve duhet të marrin në konsideratë, varësisht nga konteksti dhe pikëpamjet e të mbijetuarve/ave, kthimin e tokës dhe rishpërndarjen e tokës, të drejtat e trashëgimisë

për gratë e veja, si pasojë e luftës, dhe gratë e të zhdukurve me forcë, si dhe qasjen në kredi dhe arsim si dhe ngritje të kapaciteteve dhe trajnime. Reparacionet duhet gjithashtu të sigurojnë qasje në mundësitë për gjenerimin e të ardhurave, në mënyrë që të mbijetuarat/it në zonat rurale dhe urbane të fillojnë të rindërtojnë jetën dhe të ardhmen e tyre ekonomike dhe shoqërore—kjo mund të jetë një mjet i rëndësishëm për rritjen e fuqizimit dhe autonomisë ekonomike të grave. Për më tepër, programet e reparacioneve duhet të përfshijnë ofrimin e kujdesit shëndetësor falas, duke përfshirë kujdesin shëndetësor mendor dhe qasjen në shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese (si kirurgjia e fistulave për të mbijetuarit e dhunës seksuale).

Dhuna seksuale gjatë konfliktit, ndër të tjera, ka synuar të shfuqizojë gratë dhe burrat dhe të destabilizojë komunitetin. Ky lloj i dhunës përdoret si një mjet lufte, sepse autorët e dhunës e kuptojnë që këto akte kanë potencial shkatërrues për të prishur strukturat individuale, shoqërore dhe familjare përmes dëmtimeve fizike dhe psikologjike dhe stigmatizimit. Dhuna seksuale është një mënyrë që ushtarët të poshtërojnë dhe nënshtrojnë popullsinë dhe të zbusin rezistencën. Kjo është një armë efektive sepse efektet e saj zgjasin shumë pas kryerjes së aktit fillestar të dhunës; Vuajtjet dhe traumat vazhdojnë edhe pas mbarimit të konflikteve dhe negociatave për paqe. Në mënyrë që reparacionet të jenë me të vërtetë transformuese, ato duhet të fuqizojnë në mënyrë proaktive individët, familjet dhe komunitetin e pafuqishëm.

Në këtë drejtim, vetë procesi i dëmshpërblimit mund të jetë një mjet kritik për fuqizimin e të mbijetuarve/ave. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse ato/ata mendojnë se kanë mundësi të kontribuojnë në proceset që do të përcaktojnë se si do të jenë në gjendje ata të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe të ndajnë perspektivat e tyre mbi nevojat për të stabilizuar shoqëritë dhe rindërtuar marrëdhëniet mes njerëzve. Shumë shpesh, siç përmendën disa folës në konferencë, të mbijetuarat/it trajtohen si subjekte. Autoritetet dhe ekspertët flasin në emër të tyre, proceset i injorojnë ato/ata, agjencitë zhvlerësojnë apo ulin kapacitetet e tyre të natyrshme dhe komuniteti të cilit ata/ata i përkasin mund të vazhdojë t'i stigmatizojë. Megjithatë, siç u tha nga disa udhëheqës të shoqërisë civile, procesi i përfshirjes së të mbijetuarve/ave në avokim, negociim, projektim, zbatim, përcjellje dhe monitorim të rregullave procedurale dhe mekanizmave për reparacione—përveç dhënies së përfitimeve "tradicionale" duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve dhe aftësitë, trajnimin dhe aftësimin teknik, mbështetjen për sa i përket shëndetit fizik dhe atij psikik-sociale, për të përmendur disa—ishte shpesh një burim kryesor i fuqizimit dhe transformimit të të mbijetuarve/ave në shoqëritë në të cilat jetojnë.

19 Organizata e Kombeve të Bashkuara (2014). Udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm: Reparacionet për Dhunën Seksuale Gjatë Konfliktit, qershor, f. 9-10.



Përfundimisht, pjesëmarrësit, në disa prej diskutimeve, përsëritën nevojën që të gjithë aktorët të shmangin t'i shohin apo përlogarisin të mbijetuarat/it vetëm nëpërmjet identitetit të tyre si të mbijetuar/a të sulmit seksual, por më mirë t'i shohin ata/ato dhe të njohin të gjitha përvojat e tyre të konfliktit, të gjitha identitetet e tyre dhe, mandej, të vlerësojnë të gjithë diversitetin e tyre të përvojës dhe perspektivës që ata sjellin në çdo proces.

## 5. Bashkëpunimi zhvillimor duhet të mbështesë detyrimin e Shteteve për të ofruar qasje në riparacione.

“Ndonëse riparacionet dhe zhvillimi përbëjnë dy të drejta të veçanta dhe të ndara, krijimi i lidhjeve me aktorët e zhvillimit dhe programet mund të jenë të dobishme për të ofruar riparacione të qëndrueshme dhe transformuese, veçanërisht në një vend të prekur nga shkeljet masive të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe të ligjit ndërkombëtar humanitar, dhe varfërisë”. Udhëzuesi i SP-së, faqe 9.

Reparacionet dhe zhvillimi janë dy të drejta të dallueshme, por ato mund të jenë plotësuese dhe duhet të punojnë në sinergji. Udhëzuesi i SP-së thekson se programet e riparacioneve duhet të lidhen me programet e zhvillimit për të rritur ndikimin transformues të riparacioneve dhe për të ofruar përfitime reciproke dhe afatgjata.<sup>19</sup>

Gjatë hartimit të programeve të dëmshpërblimeve për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale në konflikt, mund të ketë mundësi për t'u angazhuar me aktorët e projekteve zhvillimore për të siguruar që këto projekte të krijojnë kapacitete dhe infrastrukturë, të cilat do t'u lejojnë të mbijetuarve/ave të kenë qasje në riparacione nga buxheti i shtetit. Për shembull, dëmshpërblimet në formën e bursave për fëmijët e të mbijetuarve/ave mund të lidhen me projektet zhvillimore lokale për të siguruar që shkollat të qasshme dhe kanë kapacitete për të pranuar këta studentë. Udhëzuesi i SP-së gjithashtu nënvizon potencialin e qasjes së projekteve zhvillimore për të rritur respektin për të drejtat e njeriut dhe për të drejtën humanitare ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të aktorëve të shtetit për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj të mbijetuarve/ave. Në të vërtetë, kjo pikë është theksuar nga pjesëmarrësit gjatë rrjedhës së konferencës. Qasje të tilla theksojnë më tej rëndësinë e përqendrimit tek dhe pjesëmarrjes së mbijetuarve/ave, në mënyrë që aktorët shtetërorë dhe projektuesit e programeve zhvillimore të mund të identifikojnë më së miri nevojat dhe boshllëqet për sa i përket kapaciteteve janë më kritike dhe për të projektuar ndërhyrjen e tyre në përputhje me nevojat dhe boshllëqet e identifikuara.

Pjesëmarrësit kanë theksuar se përveç përfshirjes së të mbijetuarve/ave në planifikimin dhe dizajnimin e riparacioneve, duke përfshirë të mbijetuarat/it në planifikimin më të gjerë të projekteve zhvillimore dhe në vendimmarrje, mund të rrisin ndikimin potencial transformues që projektet zhvillimore mund të kenë. Kjo ka

përfitimin të dyfishtë, atë të përmirësimit të rezultateve të projekteve zhvillimore jo vetëm në aspektin e ofrimit të shërbimeve më të mira për nevojat e komuniteteve, përfshirë edhe të mbijetuarat/it, por edhe në ofrimin e mundësive për fuqizim e të mbijetuarve/ave.

Shumë e rëndësishme, pavarësisht nga rëndësia e ndërtimit të sinergjive, programet zhvillimore nuk janë dhe nuk mund të zënë vendin e programeve të riparacioneve. Siç u përmend më herët, kujdes më i madh duhet t'i kushtohet kufizimeve dhe rreziqeve të lidhjes shumë të ngushtë, ose të ballafaqohemi me riparacionet dhe programet zhvillimore. As përfshirja e aktorëve të programeve zhvillimore, duke përfshirë sistemin e OKB-së, nuk mund të zëvendësojë rolin e Shteteve në dhënien e riparacioneve dhe dëmshpërblimeve si palë përgjegjëse, as tu heq heqë obligimin shteteve për detyrat e tyre ndaj të mbijetuarve/ave apo detyrën e tyre për të pranuar përgjegjësinë për dhunën seksuale (dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut).

### BOX 2

#### Asgjë për Ne pa Ne

Gjatë takimit dy-ditor, nevoja për të përfshirë të mbijetuarat/it në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të riparacioneve, por edhe në çështje të avokimit, informimit dhe përpjekjeve për ndërgjegjësim ishte një refren i zakonshëm. Për shembull, pjesëmarrësit folën për rëndësinë që të sigurohet se të mbijetuarat/it janë duke udhëhequr fushatat e avokuese që synojnë që ligjvënësit dhe autoritetet të sigurojnë që përvojat e tyre dhe nevojat e tyre do të merren parasysh dhe komunikohen në atë mënyrë që fuqizojnë ato. Përveç kësaj, përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për të thyer stigmatizimin e të mbijetuarave/ëve, për të siguruar që të mbijetuarat/it dhe familjet e tyre janë në dijeni dhe mund të marrin pjesë në proceset konsultative, apo thjesht janë të vetëdijshëm për mekanizmat ekzistues në dispozicion të tyre, duhet gjithashtu të jenë të dizajnuara me duke synuar në thelb perspektivat e të mbijetuarave/ve. Kjo do të sigurojë që mesazhet nuk çojnë në stigmatizim të mëtejshëm, ose 'lënë jashtë' të mbijetuarat/it në komunitetet ku stigmatizimi mbetet një pengesë e madhe.

Në të vërtetë, për të realizuar potencialin e tyre transformues, riparacionet dhe mekanizmat e tjerë të drejtësisë tranzicionale, duhet të

jenë pjesë e një agjende afatgjate të reformës institucionale dhe programeve zhvillimore të ankoruara në ndryshimin e së ardhmes, si dhe adresimin e së kaluarës. Në këtë drejtim, reparacionet duhet t'i njohin dhe t'i përgjigjen faktit se fuqizimi i grave dhe barazia gjinore mbajnë potencialin më të madh për paqen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## **6. Duhet të sigurohet një pjesëmarrje dhe konsultim kuptimplotë i të mbijetuarve/ave në hartëzimin, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e reparacioneve.**

“OKB-ja duhet të avokojë dhe të mbështesë pjesëmarrjen dhe konsultimet me viktimat në mënyrë që të sigurohet se reparacionet kanë ndikimin e synuar, janë perceptuar si të tilla dhe se ka pronësi mbi procesin. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për të siguruar që reparacionet janë të arritshme dhe se ato nuk përjashtojnë apo marginalizojnë ndonjë grup viktimash.

Sigurimi i qasjes së mëtejshme kërkon identifikimin e duhur të pengesave ligjore, kulturore, ekonomike dhe pengesave të tjera të gjetura nga viktimat, si dhe shqetësimet e tyre, duke përfshirë mungesën e kushteve të sigurisë, mungesën e resurseve ekonomike dhe frikën e hakmarrjes ose izolimit. Viktimat e dhunës seksuale mund të jenë, për shembull, persona të zhvendosur brenda vendit ose refugjatë dhe për këtë arsye nuk mund të marrin pjesë ose të konsultohen lehtësisht. Politikat dhe mekanizmat e reparacioneve duhet të parashikojnë masa të posaçme për të adresuar këto pengesa për të inkurajuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e viktimave.” Udhëzuesi i SP-së, faqe 10-11.

Aktorët e shoqërisë civile që punojnë në të gjithë Ballkanin kanë një kuptim të qartë se si dhe pse është e rëndësishme të angazhohen drejtpërsëdrejti me të mbijetuarat/it dhe t'i përfshijë ata/ato në të gjitha aspektet e avokimit, hartimit të programit, zbatimit dhe vlerësimit. Gjatë dhe pas konflikteve të armatosura në Ballkanin Perëndimor, ofruesit individualë të shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor, grupet e grave dhe organizatat me bazë në komunitet luajtën rol vendimtar në mbështetjen e të mbijetuarve/ave të dhunës seksuale në konflikt në mungesë të një përgjigjeje të koordinuar nga agjencitë ndërkombëtare apo autoritetet

lokale. Këta "reagues të parë" jo vetëm që ofruan mbështetje mjekësore, psikologjike, ekonomike dhe në disa raste ligjore, por disa nga to gjithashtu mblodhën dhe ruajtën dëshmi mbi dëshmitë e dhunës seksuale në konflikt dhe dëshmi të të mbijetuarve/ave. Organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e pas-konfliktit bënë pak, menjëherë pas luftërave në rajon, për të siguruar pjesëmarrjen kuptimplote të grave, për të thënë edhe më pak të mbijetuarve/ave të DhSGJK-së, në vendimmarrjen për rindërtimin, zhvillimin dhe krijimin e institucioneve pas konfliktit. Kur ligjet për viktimat civile të konflikteve u miratuan fillimisht, të mbijetuarit e dhunës seksuale në konflikt u konsultuan rrallë dhe si rrjedhojë u lanë anash në masë të madhe si një kategori që meritonte reparacione. OSHC-të dhe grupet e të mbijetuarve/ave është dashtë të evokonin për gati dy dekada për të drejtën e tyre për të marrë pjesë në legjislacionin dhe hartimin e politikave për reparacione.

Për shembull, në Kosovë, pas miratimit të ligjit fillestar për të mbijetuarat/it civilë të luftës në vitin 2006, pa ndonjë informatë dhe të dhëna të ofruara nga gratë e mbijetuara të DhSNK-së dhe nga organizatat e grave të mobilizuara për të nxitur një ndryshim në ligj<sup>20</sup> që do të përfshinte të mbijetuarat/it e dhunës seksuale në konflikt, si një kategori e ligjshme dhe e kualifikuar për programet e reparacioneve. Grupet si Rrjeti i Grave të Kosovës kanë kërkuar që të mbijetuarat/it të konsultohen gjatë hartimit të amendamentit dhe kanë ndihmuar në zbatimin e një fushate avokimi në nivel vendi, e cila siguroi mbështetjen të nivelit të lartë të qeverisë për këtë ndryshim. Presidentja e katërt e Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, atëherë është dëshmuar të jetë një aleat i jashtëzakonshëm, duke inkurajuar jo vetëm Kuvendin e Kosovës që të miratojë legjislacionin e ri, por edhe të formojë një Këshill Kombëtar për të Mbijetuarat/it. Këshilli mori një qasje gjithëpërfshirëse dhe kreative për të trajtuar shumë nga pengesat ekzistuese që parandalonin të mbijetuarat/it të kenë qasje në shërbime dhe përfitime. Ligji është shembull i mundësive në dispozicion të qeverive për t'i shërbyer të mbijetuarve/ave (shih rastin e studimit për Kosovën në tekstin më poshtë).

Një shembull tjetër vjen nga Kroacia, ku, si në Kosovë, menjëherë pas luftës ishin grupet e shoqërisë civile, të udhëhequra pjesërisht nga Qendra për gratë viktimat të luftës, e cila mori rolin udhëheqës në sigurimin e kujdesit

20 Ky është një amendament i ligjit Nr. 03 / L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Në Kosovë, të mbijetuarit organizuan dhe avokuan për ndryshime të ligjeve ekzistuese sesa të hartojnë ligje të reja, të posaçme, nga të cilat kishin frikë se mund t'i stigmatizoheshin edhe më tej.

21 UNDP (2013). Vlerësimi i numrit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës atdhetare në territorin e Republikës së Kroacisë dhe formave optimale të kompensimit dhe mbështetjes për viktimat. Zagreb. Në dispozicion në: <http://www.hr.undp.org/content/dam/croatia/docs/Research%20and%20publications/socialinclusion/UNDP-HR-SEXUAL%20VIOLENCE%20IN%20CONFLICT-RESEARCH-ENG-2014.pdf>

psikologjik për të mbijetuarat/it dhe mbledhjen e provave. Deri në vitin 2011-12 autoritetet kroate nuk treguan ndonjë interes të posaçëm edhe / apo të vërtetë për të mbijetuarat/it e DhSGJK-së dhe reparacionet. Në vitin 2011, zyra e UNDP-së në Kroaci dhe zyra e Presidentit të Kroacisë organizuan një tryezë të rrumbullakët në Vukovar ku u adresuan aspekte ndërdisiplinore të dhunës seksuale në luftë, që u pasuan me diskutimet mbi masat e mbrojtjes, rimëkëmbjes dhe drejtësisë për të mbijetuarat/it e përdhunimit gjatë luftës. UNDP, me mbështetjen e zyrës së Presidentit të Kroacisë, mblodhi të dhëna për të mbijetuarat/it jo vetëm për të ndihmuar për të ditur numrin e saktë të tyre, por edhe në zhvillimin e një baze të provave dhe një sërë rekomandimesh për reparacione për të mbijetuarat/it.<sup>21</sup> Në të njëjtën kohë, Ministria e veteranëve të luftës themeloi një grup punues mbi të drejtat e të mbijetuarve/ave të dhunës seksuale gjatë konfliktit. Duke përdorur të dhënat e UNDP-së, Grupi i Punës filloi hartimin e legjislacionit të ri për të drejtat e të mbijetuarve/ave, i cili u miratua në qershor të vitit 2015. Ky legjislacion ofroi reparacione të plota administrative, të bazuara në parimin Bona Fide<sup>22</sup>, dhe përcaktoi formimin e një komisioni për të shqyrtuar pretendimet e të mbijetuarve. Komisioni ka përfshirë praktikues të shëndetit mendor dhe fizik, si dhe ekspertë ligjorë, të cilët kanë përvojë të gjerë në punën e drejtpërdrejtë me të mbijetuarat/it. Ligji redukton në masë të madhe barrën e dëshmisë mbi të mbijetuarat/it, por gjithashtu siguron që të mbijetuarat/it mund të kërkojnë reparacione pavarësisht nga përkatësia etnike e kryesve të dhunës mbi to/ta (shih rastin e studimit të Kroacinë në tekstin më poshtë).

Ndërsa OJQ-të ndërkombëtare (OJQ-N-të), agjencitë ndërkombëtare dhe disa qeveri kanë filluar të përfshijnë zërin dhe perspektivat e të mbijetuarve/ave rreth 20 vjet pas konflikteve, që kërkojnë shumë kohë për të kontribuar në eliminimin e shumë pengesave për drejtësinë riparuese dhe stabilitetin dhe harmoninë shoqërore. Për shembull, duke mos i përfshirë të mbijetuarat/it në bisedimet për paqe, jo vetëm që mungoi plotësisht përfshirja e nevojave të tyre, por u humb edhe perspektiva vendimtare për demilitarizimin dhe tranzicionin e shoqërive. Disa folës kanë theksuar rëndësinë e përfshirjes së grave dhe të mbijetuarve/ave të DhSNK-së në të gjitha nivelet dhe gjatë të gjitha fazave, pasi aktorët ndërkombëtarë dhe udhëheqësit e lutës u mblodhën për të negociuar ndërprerjen

e armiqësive, marrëveshjet e paqes dhe planifikimit të zhvillimit dhe rindërtimit.

## **7. Duhet të vihen në dispozicion reparacionet e përkohshme urgjente për të trajtuar nevojat e menjëhershme dhe për të shmangur dëmin e pariparueshëm.**

“Ofrimi i kompensimit të plotë për viktimat kërkon kohë, burime, koordinim, ekspertizë dhe vullnet politik. Në shumicën e përvojave të deritanishme, reparacionet janë siguruar shumë vite pas konfliktit. Për këto arsye, OKB-ja duhet gjithashtu të mbështesë përpjekjet për të siguruar reparacione urgjente të përkohshme për t’iu përgjigjur dëmeve më urgjente dhe të menjëhershme që prekin viktimat e dhunës seksuale në konflikt. Reparacionet e përkohshme urgjente duhet të dallohen nga masat e asistencës sociale ose humanitare, pasi ato bazohen në njohjen e përgjegjësisë shtetërore dhe kërkojnë mbështetje shtetërore dhe politike.” Udhëzuesi i SP-së, faqe 12.

Para ndërprerjes së dhunës, përpara arritjes së marrëveshjeve të paqes, të mbijetuarat/it e dhunës seksuale në konflikt kanë nevojë për shërbime, pasi shumë nga ta/to janë të zhvendosur brenda vendit ose janë refugjatë që ikin nga konflikti. Përfaqësuesit e parë që ofrojnë këto shërbime humanitare kanë një mundësi që të marrin informata të vlefshme për dhunën seksuale në konflikt për të ndihmuar në udhëheqjen e reagimit, duke përfshirë reparacionet urgjente dhe të përkohshme. Shembuj të këtyre masave të përkohshme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, shpërndarjen e emergjentë të parave të gatshme për të mbijetuarat/it ose qasjen e shpejtë në shërbimet shëndetësore për të administruar medikamente anti-retrovirale dhe medikamente të tjera, kryerjen e operacioneve të fistulave dhe ofrimin e kujdesit psikiatrik dhe atij psikik-social. Në kaosin e konfliktit dhe situatave pas konfliktit, mund të jetë e vështirë, nëse jo e pamundur, që autoritetet ose agjencitë ndërkombëtare të koordinojnë dhe të ofrojnë reparacione të përkohshme urgjente. Sidoqoftë, mekanizmat e lokalizuar, siç janë komisionet e së vërtetës dhe gjykatat e grave ndër të tjera, mund të ndihmojnë në krijimin e një baze për të administruar programimin e përkohshëm të reparacioneve.

22 Parimi Bona fide, që do të thotë në mirëbesim, pa pasur qëllim të mashtrorë, të pranojë fjalën e viktimit dhe të mos kërkojë dëshmi shtesë, siç janë shënimet mjekësore ose dokumentacion policor, shihet si një përparim pozitiv për të gjithë të mbijetuarat/it dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale gjatë konfliktit.

---

Të mbijetuarat/it janë të gatshëm për të folur menjëherë. Dhe ne shpesh humbasim këtë mundësi. Nëse ju nuk i merrni tregimet e tyre menjëherë, ju humbni një mundësi të vlefshme. Menjëherë pas luftës, të mbijetuarit janë në mesin e shumë të tjerëve të goditur nga lufta—statusi i tyre si të mbijetuar/a është më i normalizuar, por me kalimin e kohës, pasi ata/ato kanë kërkuar të ri-integrohen në shoqëri, ndjenja e tyre e izolimit si "të mbijetuar/a" rritet, ata/ato janë në mesin e pak të mbijetuarve/ave, ndikimi i rritjes së stigmës, ata/ato mbyllet dhe nuk flasin për përvojat e tyre. Mbani në konsideratë momenti për monitorimin dhe raportimin mbi DhSGJK-në është gjatë krizave të refugjatëve, kur njerëzit janë të gatshëm të flasin për këto çështje.

Zonja Flora Macula

Shefe e Zyrës, UN Women, Kosovë

---

Megjithatë, është shumë me rëndësi që sigurimi i reparacioneve të përkohshme urgjente për të mbijetuarat/it të mos politizohen ose të përdoren si justifikim për kufizimin apo shkurtimin e programimit afatgjatë të reparacioneve. Duhet të bëhen dallime të qarta ndërmjet dy formave të reparacioneve, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë ideale për njëra-me-tjetrën për të ofruar shërbime më të gjera për të mbijetuarat/it, familjet dhe komunitetin për një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë.

## 8. Duhet të ekzistojnë rregulla të përshtatshme procedurale për procedurat që përfshijnë dhunën seksuale dhe reparacionet.

"...the OKB-ja e mbështet miratimin e rregullave specifike procedurale për dhunën seksuale, në procedurat gjyqësore dhe ato administrative, në mënyrë që ta mbrojë interesin e viktimës dhe t'i marrë parasysh të drejtat e të akuzuarit." Udhëzuesi i SP-së, faqe. 13.

Pas konfliktit të dhunshëm dhe luftës, institucionet shtetërore — duke përfshirë sistemet ligjore dhe ato të drejtësisë, mbrojtjet sociale dhe programet administrative, si dhe infrastrukturën fizike dhe shërbimet — janë dobësuar ndjeshëm, ose madje nuk ekzistojnë (nuk janë reale). Ky kontekst i kaosit e mundëson mosndëshkimin, si dhe i shfuqizon rrugët institucionale dhe ato të ndjeshme gjinore, për

drejtësi për të mbijetuarit dhe familjet e tyre. Siç theksuan disa pjesëmarrës, është thelbësore, që në fazë të hershme, të fillohet procesi i krijimit, riparimit ose forcimit të rregullave procedurale që i sigurojnë të drejtat e të mbijetuarve, dhe u mundësojnë atyre qasje në mekanizmat e reparacioneve nëpërmjet gjykatave (padi kriminale dhe civile), si dhe përmes proceseve administrative.

In Në disa vende, kohëve të fundit, autoritetet kanë rishikuar legjislacionin që zbatohet për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Për shembull në Kroaci, studimi i vitit 2013, i udhëhequr nga UNDP-ja<sup>23</sup> mbi mjetet për reparacionet identifikoi lex specialis<sup>24</sup> si kornizën më të mirë ligjore për të tejkaluar faktin se legjislacioni, menjëherë pas luftës, ka lënë pas dore trajtimin e çështjes së të drejtave të të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin (DHSNK). Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Republikën Serbe, Kroaci dhe në Kosovë ku reparacionet, për të mbijetuarit e DHSNK-së, janë aktualisht nën rishikim ose janë rishikuar kohëve të fundit, autoritetet duket se po kujdesen për përfshirjen e perspektivave të të mbijetuarve, i favorizojnë procedurat që e ulin stigmatizimin e mëtejshëm dhe krijojnë mekanizma të tillë siç janë grupet punuese dhe komisionet e rishikimit të përbërë nga anëtarë të kualifikuar, me përvojë në punën me të mbijetuarit e DHSNK-së, për të bërë rekomandime të mëtejshme dhe për t'i rishikuar kërkesat. Në secilin nga këto kontekste, agjencitë ndërkombëtare, OJQ-të ndërkombëtare dhe organizatat lokale të shoqërisë civile kanë ofruar mbështetje teknike, ngritje të kapaciteteve, trajnime dhe këshilla për autoritetet, ligjvënësit dhe ofruesit e shërbimeve për t'i sensibilizuar ata për nevojat e të mbijetuarve. Përderisa këto janë përparime pozitive, mbetet ende shumë punë për t'u bërë në përmbushjen e sfidave me të cilat përballen të mbijetuarit, familjet e tyre, komunitetet e tyre dhe për t'i stabilizuar më tej shoqëritë e tyre.

23 UNDP (2013). Vlerësimi i numrit të viktimave të dhunës seksuale...Në dispozicion këtu: <http://www.hr.undp.org/content/dam/croatia/docs/Research%20and%20publications/socialinclusion/UNDP-HR-SEXUAL%20-VIOLENCE%20-IN%20-CONFLICT-RESEARCH-ENG-2014.pdf> <http://www.hr.undp.org/content/dam/croatia/docs/Research%20and%20publications/socialinclusion/UNDP-HR-SEXUAL%20-VIOLENCE%20-IN%20-CONFLICT-RESEARCH-ENG-2014.pdf>

24 Në të drejtën ndërkombëtare, konceptet e lex specialis dhe lex generalise përcaktojnë marrëdhënien ndërmjet të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare në nenin 2 të përbashkët, konfliktit ndërkombëtar të armatosur dhe nenit 3 të përbashkët, konfliktit të armatosur jo ndërkombëtar siç përcaktohet nga Konventat e Gjenevës. Në të gjitha situatat e konfliktit të armatosur, zbatohet ligji i të drejtave të njeriut, megjithatë, kur lex universalis dhe lex specialis janë në kundërshtim, zbatohet lex specialis. Shiko Zyrën e Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut - OHCHR (2011). Mbrojtja Ligjore Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut në Konfliktet e Armatosura. Në dispozicion në: [http://www.ohchr.org/Documents/Publications/HR\\_in\\_armed\\_conflict.pdf](http://www.ohchr.org/Documents/Publications/HR_in_armed_conflict.pdf)

# BALLKANI PERËNDIMOR SI LABORATOR PËR REPARACIONET

## Praktikat e mira për reparacionet

Dialogët, nga konferenca dy ditore, u pasuruan me identifikimin e praktikave të mira të ndara me padurim nga pjesëmarrësit. Të përmbledhura, këto praktika të mira u përqendruan në disa rekomandime:

- të garantuarit e konfidencialitetit të të mbijetuarve;
- të siguarit se procedurat për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve të reparacioneve janë bërë me pjesëmarrje dhe se të mbijetuarit e kanë mundësinë që të kontribuojnë dhe të dëgjohen në çdo hap;
- të siguarit se reparacionet janë të përshtatura për kontekstin dhe nevojat lokale, dhe se ato janë mjaft komplekse dhe të shumëllojshme për t'iu përgjigjur këtyre nevojave;
- të pranuarit e rëndësisë së njohjes për të mbijetuarit meshkuj të DHSNK-së; dhe
- të siguarit që reparacionet i mbështesin reformat transformuese dhe barazuese ekonomike, ligjore, gjyqësore, të sigurisë.

Më shumë informacione, mbi rekomandimet nga konferenca, janë të detajuara më poshtë në seksionin mbi "Mënyrat e reja të të menduarit për reparacionet: Rekomandime për akterët kryesorë".



## Ligjet mbi Reparacionet për DHSNK-në në Ballkanin Perëndimor

KOSOVË	
Ligji/rregullorja për rregullimin e DhSNK-në	<ul style="list-style-type: none"> <li>2011 – Ligji Nr. 04/L-054, Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre</li> <li>2014 – Ligji Nr. 04/L-172, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre</li> <li>2015 – Rregullorja (QRK) nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës</li> <li>2016 – Rregullorja (QRK) Nr. 10/2016 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) o. 22/2015 Për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës</li> </ul>
Nën cilën kategori janë të përfshirë të mbijetuarit e DHS-së?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viktimat e dhunës seksuale të luftës<sup>25</sup></li> </ul>
Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>"Viktimë e dhunës seksuale të luftës" = "person që i ka mbijetuar dhunës seksuale dhe përdhunimit brenda periudhës kohore nga 27.02.1998 deri më 20.06.1999"<sup>26</sup></li> </ul>
Kush përjashtohet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në mesin e të mbijetuarve të DHS-së, ata që përjetuan dhunë seksuale në çdo kohë tjetër përveç periudhës kohore (ndërmjet 27.02.1998 dhe 20.06.1999) dhe ata që zgjedhën të mos aplikojnë, ose ata që nuk janë në gjendje të aplikojnë për verifikim.</li> </ul>
Përfitimet e reparacioneve	<p>Individuale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pension personal i invalidit (në përputhje me pensionet për invalidët civilë)<sup>27</sup></li> <li>Shërbimet shëndetësore jashtë vendit për kushtet shëndetësore, që janë pasojë e luftës, për të cilat nuk ka trajtim në vend;</li> <li>Prioritet në punësimin publik dhe atë privat</li> <li>Lirimi nga taksat e pronës (nëse këtë e lejojnë kushtet ekonomike)</li> <li>Kujdesi rezidencial<sup>28</sup></li> </ul> <p>Kolektive</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Asnjë</li> </ul>
A duhet që të mbijetuarit e DHS-së t'i plotësojnë kushtet për invaliditet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo, të mbijetuarit e DHS-së janë të përjashtuar nga vlerësimi i nivelit të invaliditetit të cilit i nënshtrohen invalidët e tjerë civilë.<sup>29</sup></li> </ul>

25 UN Women (2016). "Së shpejti reparacionet për të mbijetuarit e dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë", 15 mars 2016. Qasur më 13 dhjetor 2016. Në dispozicion në: <http://eca.unwomen.org/en/news/stories/2016/03/kosovo--new-regulation-sexual-violence>.

26 Ligji Nr. 04/L-172, neni 4, 20 mars 2014. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Në dispozicion në: <http://www.kuvend-ikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-172%20a.pdf>.

27 Ibid., neni 5.

28 Ibid., neni 6.

29 Ibid., neni 7. Megjithatë, kjo është e hapur për interpretim. Versionet e ligjit, në gjuhën shqipe dhe atë serbe, i përjashtojnë, nga testimi i invaliditetit, vetëm personat që kanë vuajtur "përdhunim" por jo kategorinë më të gjerë të "dhunës seksuale".

Shuma e përfitimit/ eve financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shuma e pensionit bazë do të vendoset nga qeveria.<sup>30</sup></li> </ul>
Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave të të mbijetuarve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji e ka përcaktuar krijimin e një komisioni qeveritar, të përbërë nga një përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Instituti për Krime Luftë, si dhe nga një psikolog, psikiatër, avokat dhe një përfaqësues i shoqërisë civile me përvojë në ofrimin e mbështetjes për dhunën seksuale në baza gjinore (DHSBGJ).<sup>31</sup></li> </ul>
Afatet ose periudha kohore e kufizimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pesë vjet nga fillimi i punës së komisionit përkatës (ndryshe nga kategoritë e tjera të viktimave, të cilat kanë një vit kohë).</li> </ul>
Sigurimi i privatësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji kërkon që qeveria t'i mbrojë të dhënat personale dhe identitetin e atyre personave që aplikojnë si të mbijetuar nga DHS-ja.</li> </ul>

## BOSNJË DHE HERCEGOVINË

### Republika Serbe<sup>34</sup>

Ligji/rregullorja për rregullimin e DhSNK-në	<ul style="list-style-type: none"> <li>1993 – Ligji Nr. 25/93, Ligji për Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës<sup>35</sup></li> <li>1994 – Ligji Nr. 1/94 dhe 32/94 (ndryshimet)<sup>36</sup></li> <li>2007 – Ligji Nr. 37/07 dhe 60/07 (ndryshimet)<sup>37</sup></li> <li>2009 – Ligji Nr. 111/09 dhe 118/09 (ndryshimet)<sup>38</sup></li> <li>2010 – Ligji Nr. 02/4.3-409 /10 (versioni i konsoliduar)<sup>39</sup></li> </ul>
Nën cilën kategori janë të përfshirë të mbijetuarit e DHS-së?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viktimat civile të luftës</li> </ul>
Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viktimat Civile = 1) personat që pësuan dëmtime fizike për shkak të abuzimit, përdhunimit, paraburgimit (burgosjes, kampit të përqendrimit, kufizimit, punës së detyruar) ose që gjatë kohës kur nga armiku, kanë qenë të detyruar të largohen, kanë pësuar plagosje, lëndim ose traumë, gjë që shkaktoi dëmtim trupit në një masë prej së paku 60 për qind<sup>40</sup> si dhe njerëzit të cilët në rrethanat e përmendura janë vrarë, vdiqën ose janë zhdukur; 2) Personat që kanë pësuar dëmtime fizike prej së paku 60 për qind si pasojë e plagëve ose lëndimeve të shkaktuara në lidhje me operacionet ushtarake, si bombardimet, luftimet në rrugë, plumbat qorr, granatimet; 3) Personat që kanë pësuar dëmtime fizike prej të paktën 60 për qind si pasojë e plagëve ose lëndimeve të shkaktuara nga materiali i mbetur i luftës ose si rezultat i akteve armiqësore të sabotazhit.<sup>41</sup></li> <li>Të drejtat e përcaktuara në ligj po ashtu gëzohen nga anëtarët e familjes së personave që u vranë, vdiqën ose u zhdukën në rrethanat e sipërpërmendura dhe nga familjarët e personave të vdekur që morën statusin e "viktimës civile të luftës".</li> </ul>

30 Ibid., neni. 7.

31 Ibid., neni. 8.

32 Ibid., neni. 9.

33 Ibid., neni. 19.A ("Mbrojtja e të dhënave të personave që i kanë mbijetuar abuzimit seksual dhe përdhunimit").

34 Në Republikën Serbe, një pjesë e re e legjislacionit është duke u zhvilluar për t'i siguruar të drejtat e viktimave të torturës. Të mbijetuarit e DhSNK-së, sipas këtij ligji, do të jenë një kategori e veçantë.

35 Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, Instituti i Personave të Zhdukur në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Qendra për Qasje të Lirë në Informata (2007). 36 Udhëzues për Viktimat Civile të Luftës: Si të gëzohet e drejta për mbrojtje në cilësinë e viktimës civile të luftës në Republikën Serbe. Seksioni I, paragrafi 1. Në dispozicion në: <http://www.icmp.int/wp-content/uploads/2014/08/guidebook-wictim-of-war-rs.pdf>.

36 Ibid.

37 Ibid.

38 Qendra për të Drejtën Humanitare (2004). Reparacionet administrative në Serbi - Një analizë e kornizës ligjore ekzistuese, f. 4. Në dispozicion në: [http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2014/03/Administrative\\_reparations\\_in\\_Serbia\\_an\\_analysis\\_of\\_the\\_existing\\_legal\\_framework.pdf](http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2014/03/Administrative_reparations_in_Serbia_an_analysis_of_the_existing_legal_framework.pdf).

39 Ligji për Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës. Gazeta Zyrtare, nr. 79/07. Komisioni Legjislativ i Asamblesë Kombëtare të Republikës Serbe, 15 mars, 2010. Ky ligj është hartuar që nga janari i vitit 2017, por ende nuk është miratuar. Vegza të cilën e kemi përfshirë në fillim tashmë nuk funksionon më. Ne duhet të gjejmë një vegzë që na drejton tek ligji i Republikës Serbe: 2010 – Ligji Nr. 02/4.3-409 /10 (versioni i konsoliduar). Nëse nuk ka vegzë, nga ku njerëzit mund ta gjejnë ligjin në internet atëherë do ta heqim nga teksti: Në dispozicion në: <http://pravnik.ba/wp-content/uploads/2015/03/ZAKON-O-ZASTITI-CIVILNIH-ZRTVA-RATA-RS.pdf> – Ky ligj është hartuar, por që nga janari 2017, nuk është miratuar ende.

40 Ibid.

41 Shënimi më lartë (Supra note) 37, seksioni I, paragrafi. 4.

Kush përjashtohet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbijetuarit e dhunës seksuale të cilët nuk mund të demonstrojnë të paktën 10 për qind të dëmtimit trupor si shtesë ndaj dëmtimit psikologjik (i cili konsiderohet i barabartë me 50 për qind të dëmtimit trupor).<sup>42</sup></li> <li>• Viktimat civile, duke përfshirë të mbijetuarit e dhunës seksuale, të cilët pësuan dëmtime trupore në një kohë të ndryshme nga ajo (a) pas 9 janarit 1992 (në rastin e shtetasve të RS-së) dhe (b) ndërmjet 18 gushtit 1990 dhe 9 janarit 1992 (në rast të is-shtetasve të RS-FJ-së për sa kohë që ata e kanë marrë shtetësinë e RS-së dhe kanë leje të përhershme qëndrimi).<sup>43</sup></li> <li>• Viktimat civile, duke përfshirë të mbijetuarit e dhunës seksuale, të cilët nuk kanë aplikuar për përfitime para skadimit të afatit të skaduar në vitin 2007.<sup>44</sup></li> <li>• Viktimat civile të cilat nuk kanë të dhëna mjekësore, të lëshuara më pak se një vit, prej ditës kur ka ndodhur dëmtimi, do të thotë nga dita kur janë ndalur rrethanat në të cilat ka ndodhur dëmtimi.</li> <li>• Viktimat civile që nuk janë të regjistruara si shtetas të entitetit të Republikës Serbe.</li> <li>• Identiteti i kryerësit nuk përbën bazë për përjashtim, përveç rastit të refugjatëve, ku kryerësi duhet të jetë nga forca armike në mënyrë që viktima të kualifikohet për përfitime<sup>45</sup>. Ligji po ashtu thekson se "të drejtat e përcaktuara në këtë ligj nuk mund të gëzohen nga persona që ishin anëtarë të forcave armike ose që e ndihmuan armikun".</li> </ul>
Përfitimet e reparacioneve	<p>Individuale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shuma e asistencës invalidore (asistencë invalidore familjare)</li> <li>• Shtesa për kujdes dhe ndihmë nga një person tjetër</li> <li>• Shtesa për një anëtar të familjes të paaftë për të fituar për jetesë</li> <li>• Mbështetje financiare shtesë</li> <li>• Shtesë për prindërit e vetëm</li> <li>• Kujdesi shëndetësor</li> <li>• Rehabilitimi profesional<sup>46</sup></li> </ul> <p>Kolektive</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Asnjë</li> </ul>
A duhet që të mbijetuarit e DHS-së t'i plotësojnë kushtet për invaliditet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbijetuarit e dhunës seksuale duhet të tregojnë të paktën 10 për qind dëmtim trupor për t'u kualifikuar. Pjesa e mbetur prej 50 për qind (për të arritur pragun prej 60 për qind) jepet në bazë të dëmtimit psikologjik.</li> </ul>
Shuma e përfitimit/eve financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitimet mujore ndryshojnë nga 100 KM në 350 KM, varësisht prej shkallës së dëmtimit fizik.<sup>47</sup></li> </ul>

42 Sekretariati i Amnesty International (2009). Bosnja dhe Hercegovina: 'Drejtesia e kujt?': Gratë e Bosnjës dhe Hercegovinës ende janë duke pritur, f. 43. Në dispozicion këtu: <https://www.amnesty.org/en/documents/EUR63/006/2009/en/>.

43 Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Instituti i Personave të Zhdukur në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Qendra për Qasje të Lirë në Informata (2007). Shënimi më lartë (Supra note), seksioni I, paragrafi 9.

44 Ibid.

45 Shih Kombet e Bashkuara (2014). Raporti i Raportuesit Special për Promovimin e së Vërtetës, Drejtësisë, Reparacioneve dhe Garantimit të mos përsëritjes. Tetor 2014. A/69/518; dhe Qendra për të Drejtën Humanitare (2004). Reparacionet administrative në Serbi - Analizë e kornizës ekzistuese ligjore.

46 Shënimi më lartë (Supra note) 37, Seksioni III, paragrafi. 9.

47 Shënimi më lartë (Supra note) 44, f. 43.



Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave të të mbijetuarve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkohen dokumente mjekësore, të lëshuara jo më vonë se një vit prej ditës kur është shkaktuar dëmtimi ose prej ditës kur janë ndalur armiqësitë, që e vërtetojnë shkallën e dëmtimit fizik.<sup>48</sup></li> <li>• Për aplikimet vendoset nga autoritetet administrative komunale në rajonin ku përkohësisht banon aplikuesi ose aty ku e ka adresën e qëndrimit të përhershëm.<sup>49</sup></li> <li>• Ministria e Punës dhe e Veteranëve vendos për ankesat.<sup>50</sup></li> </ul>
Afatet ose periudha kohore e kufizimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Periudha fillestare e aplikimit u mbyll në vitin 2000. Mundësia e aplikimit është rihapur për gjashtë muaj në vitin 2007<sup>51</sup>, pas së cilës periudhë kohore u mbyll përsëri.</li> </ul>
Sigurimi i privatësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka përgjigje</li> </ul>

### Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës

Ligji/rregullorja për rregullimin e DHSNK-në	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1999– Ligji Nr. 36/99, Ligji mbi Bazat e Mbrojtjes Sociale, Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës dhe Mbrojtjen e Familjeve me Fëmijë<sup>52</sup></li> <li>• 2004 – Ligji Nr. 54/04 (ndryshimet)<sup>53</sup></li> <li>• 2006 – Ligji Nr. 39/06 (ndryshimet)<sup>54</sup> – Përfshirja e kompensimit të veçantë financiar për të mbijetuarit e DHSNK-së. Përveç kësaj, DHSNK-ja është përfshirë si një nënkategori e veçantë, nën viktimat civile të luftës, pa pasur nevojë të dëshmojë shkallën (përqindjen) e invaliditetit<sup>55</sup></li> <li>• 2009 – Ligji Nr. 14/09 (ndryshimet)<sup>56</sup></li> <li>• 2016 – Ligji Nr. 45/16</li> </ul>
Nën cilën kategori janë të përfshirë të mbijetuarit e DHS-së?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Viktimat e dhunës seksuale, është një nënkategori e veçantë nën viktimat civile të luftës.<sup>57</sup></li> </ul>
Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Viktimë civile e luftës = “personi i cili ka pësuar, gjatë luftës ose nga kërcënimi i drejtpërdrejtë i luftës, dhe që për shkak të plagosjes ose të ndonjë forme tjetër të torturës në luftë, ka pësuar dëmtim të trupit, duke përfshirë dëmtimin mendor ose përkeqësim të ndjeshëm të shëndetit, zhdukje ose vdekje të këtij personi” dhe personi<sup>58</sup> që vuan “nga disa sëmundje të shkaktuara nga abuzimi, privimi i lirisë, dënimi ilegal, privimi ilegal i lirisë, burgosja, ndalimi në një kamp përqendrimi, puna e detyruar gjatë luftës ose nën kërcënimin e menjëhershëm të luftës”, me kusht që sëmundja ka çuar në 'një dëmtim të ndjeshëm ndaj shëndetit’”.<sup>59</sup></li> </ul>
Kush përjashtohet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personat që nuk mund të tregojnë dëmtime trupore prej të paktën 60 për qind<sup>60</sup>, përveç rasteve të dhunës seksuale.<sup>61</sup></li> <li>• Identiteti i kryerësit nuk përbën bazë për përjashtim.<sup>62</sup></li> </ul>

48 Ibid.

49 Shënimi më lartë (Supra note) 37, Seksioni IV, paragrafi. 32.

50 Ibid.

51 Shënimi më lartë (Supra note) 44, f. 42.

52 Bosnje dhe Hercegovinë: Ligji Nr. 36/99, nenet .8, 78, 6 shtator 1999, "Mbi parimet e mbrojtjes sociale, mbrojtjen e viktimave civile të luftës dhe mbrojtjen e familjeve me fëmijë". Në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/4d30226f2.html>.

53 <http://pravnik.ba/wp-content/uploads/2015/03/ZAKON-O-ZASTITI-CIVILNIH-ZRTVA-RATA-RS.pdf>

54 <http://fmrsp.gov.ba/s/images/stories/Zakon%20o%20osnovama%20sociojalne%20zastite%20zastite%20civilnih%20zrtava%20rata%20i%20zastite%20obitelji%20sa%20djecom.pdf>

55 Zoti Dobrica Jonjić, Ministria e punës dhe politikës sociale të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, vërejtjet e bëra gjatë konferencës.

57 Saša Gajin (red.) (2015). Ligji Model për të Drejtat e Viktimave Civile të Shkeljeve të të Drejtave të Njeriut të kryera gjatë dhe në lidhje me konfliktet e armatosura në periudhën 1991-2001, në f. 26. Në dispozicion këtu: [https://issuu.com/dhrpraxis/docs/model\\_law\\_of\\_the\\_rights\\_of\\_civilian](https://issuu.com/dhrpraxis/docs/model_law_of_the_rights_of_civilian).

58 Shënimi më lartë (Supra note) 44, f. 40.

59 Shënimi më lartë (Supra note) 40, f. 13, citim i nenit 5, Ligji për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen sociale, mbrojtjen e viktimave të luftës, dhe mbrojtjen e familjeve me fëmijë, Gazeta Zyrtare e Federatës së BeH-së nr. 39/06.

60 Shënimi më lartë (Supra note) 44, f. 40.

61 Ibid., p. 41.

62 Shënimi më lartë (Supra note) 40, f. 13.

Përfitimet e reparacioneve	<p>Individuale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitimet minimale rregullohen nga ligji kornizë në nivel federate. Ato zbatohen nga ligji kantonal, i cili mund të sigurojë të drejta shtesë.</li> <li>• Asistencë për paaftësi individuale</li> <li>• Asistencë familjare</li> <li>• Trajnim profesional</li> <li>• Prioritet në punësim dhe strehim</li> <li>• Ndihmë psikologjike dhe ligjore<sup>63</sup></li> <li>• Shtesë për ndihmë dhe asistencë nga një person tjetër; Asistencë për pajisje mbështetëse ortopedike; Mbështetje financiare për shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe për blerjen e pajisjeve mbështetëse ortopedike; E drejta për trajnim profesional (trajnim për ngritjen e aftësive, kompetencave dhe zhvillimi profesional)</li> </ul> <p>Kolektive</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Asnjë</li> </ul>
A duhet që të mbijetuarit e DHS-së t'i plotësojnë kushtet për invaliditet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbijetuarit e DHS-së përjashtohen nga pragu prej 60 për qind i dëmtimit të trupit.</li> </ul>
Shuma e përfitimit/eve financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitimi për të mbijetuarit e përdhunimit është rreth 500 BAM.<sup>64</sup></li> </ul>
Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave të të mbijetuarve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Me ndryshimet e fundit, vendimet lidhur me statusin e të mbijetuarve të DHSNK-së do të lëshohen nga një komision. Më parë, procedura për aplikim si viktimë e DHS-së përfshinte certifikimin nga një shoqatë e autorizuar përmes ekzaminimeve mjekësore dhe/ose të dhënave mjekësore<sup>65</sup>. Kjo, sipas komisionit të ri, nuk do të ndodhë më.</li> <li>• Organet e përcaktuara nga kantoni rregullojnë dhe shpërndajnë përfitimet<sup>66</sup> dhe të gjitha paratë vijnë nga buxhetet federale dhe ato kantonale.</li> <li>• Ministria përkatëse federale - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale<sup>67</sup> – monitoron zbatimin e ligjit.<sup>68</sup></li> </ul>
Afatet ose periudha kohore e kufizimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka afat kohor</li> </ul>
Sigurimi i privatësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka përgjigje</li> </ul>

63 Ibid.

64 Shënimi më lartë (Supra note) 44, f. 41.

65 Ibid., f. 45.

66 Ligji Nr. 36/99, nenet .8, 78, 6 shtator 1999, "Mbi parimet e mbrojtjes sociale, mbrojtjen e viktimave civile të luftës dhe mbrojtjen e familjeve me fëmijë". Në dispozicion në: <http://www.refworld.org/pdfid/4d30226f2.pdf>.

67 Aida Malkić dhe Tea Hadžiristić (2016). Ndërthurja e pabarazive në mbrojtjen sociale në Bosnjë dhe Hercegovinë: Rezultatet e një studimi empirik. Qendra për Hulumtime Sociale ANALITIKA, në f. 8. Në dispozicion në: [http://www.analitika.ba/sites/default/files/inequality\\_eng\\_-\\_izvjestaj\\_2403.pdf](http://www.analitika.ba/sites/default/files/inequality_eng_-_izvjestaj_2403.pdf).

68 Ligji nr. 36/99, neni. 9, 6 shtator 1999., "Mbi Parimet e Mbrojtjes Sociale, Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës dhe Mbrojtjen e familjeve me Fëmijë". Në dispozicion në: <http://www.refworld.org/pdfid/4d30226f2.pdf>.

Qarku i Brçko-së	
Ligji/rregullorja për rregullimin e DhSNK-në	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendimi i Kuvendit të Qarkut të Bërçkos për Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës, nga 8 Gushti i vitit 2012 dhe Vendimi për Ndryshimin e Vendimit për Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës, nga 3 Qershori i vitit 2015.</li> </ul>
Nën cilën kategori janë të përfshirë të mbijetuarit e DHS-së?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viktimat civile të luftës</li> </ul>
Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viktimë civile e luftës konsiderohet të jetë një person i cili ka dëmtime të përhershme psikologjike si pasojë e abuzimit seksual ose përdhunimit, ku dëmtimi nuk përcaktohet me përqindje.</li> </ul>
Kush përjashtohet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>I përjashton ata që banojnë jashtë Qarkut të Brçko-së.</li> </ul>
Përfitimet e reparacioneve	<ul style="list-style-type: none"> <li>(1) Dispozitat themelore:               <ol style="list-style-type: none"> <li>asistencë invaliditeti për civilët;</li> <li>asistencë invaliditeti familjare;</li> <li>asistencë për kujdesin dhe ndihmën e një personi tjetër;</li> <li>kujdes shëndetësor dhe lirim nga shpenzimet e pjesëmarrjes për kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor;</li> <li>pajisjet ndihmëse ortopedike;</li> <li>rimbursimi për shpenzimet e varrimit.</li> </ol> </li> <li>(2) Si shtesë ndaj të drejtave të përshkruara në pikën (1), të drejtat shtesë do të përcaktohen duke përfshirë:               <ol style="list-style-type: none"> <li>asistencë financiare në mbulimin e shpenzimeve të trajtimit dhe sigurimit të pajisjeve ortopedike;</li> <li>rehabilitimin profesional, rikualifikimin dhe trajnimet shtesë;</li> <li>projekte të veçanta të punësimit;</li> <li>strehim prioritar;</li> <li>ndihmë juridike falas.</li> </ol> </li> </ul>
A duhet që të mbijetuarit e DHS-së t'i plotësojnë kushtet për invaliditet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo</li> </ul>
Shuma e përfitimit/eve financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>70 për qind e pagës mesatare mujore në Qarkun e Bërçkos (rreth 570 BAM por mund të ndryshojë varësisht nga luhatjet e pagës mesatare neto). Kostot e përfitimeve do të financohen nga buxheti i qarkut.</li> </ul>
Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave të të mbijetuarve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organi i shkallës së parë që merret me kërkesën për status është Departamenti i Shëndetësisë dhe shërbime të tjera të Qarkut të Brçko-së. Të mbijetuarit pastaj i nënshtrohen intervistës me Komisionin e QB-së për dhënien e statusit.</li> </ul>
Afatet ose periudha kohore e kufizimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka afat kohor</li> </ul>
Sigurimi i privatësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka përgjigje</li> </ul>

63 Ibid.

64 Shënimi më lartë (Supra note) 44, f. 41.

65 Ibid., f. 45.

66 Ligji Nr. 36/99, nenet .8, 78, 6 shtator 1999, "Mbi parimet e mbrojtjes sociale, mbrojtjen e viktimave civile të luftës dhe mbrojtjen e familjeve me fëmijë". Në dispozicion në: <http://www.refworld.org/pdfid/4d30226f2.pdf>.

67 Aida Malkić dhe Tea Hadžiristić (2016). Ndërthurja e pabarazive në mbrojtjen sociale në Bosnjë dhe Hercegovinë: Rezultatet e një studimi empirik. Qendra për Hulimtime Sociale ANALITIKA, në f. 8. Në dispozicion në: [http://www.analitika.ba/sites/default/files/inequality\\_eng\\_-\\_izvjestaj\\_2403.pdf](http://www.analitika.ba/sites/default/files/inequality_eng_-_izvjestaj_2403.pdf).

68 Ligji nr. 36/99, neni. 9, 6 shtator 1999., "Mbi Parimet e Mbrojtjes Sociale, Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës dhe Mbrojtjen e familjeve me Fëmijë". Në dispozicion në: <http://www.refworld.org/pdfid/4d30226f2.pdf>.

## Republika e SERBIË

Ligji/rregullorja për rregullimin e DhSNK-në	<ul style="list-style-type: none"> <li>1996: Ligji Nr. 52/96, Ligji mbi të Drejtat e Civilëve Invalidë luftës<sup>69</sup>, gjithashtu i njohur edhe si Ligji mbi të Drejtat e Invalidëve Civilë të Luftës<sup>70</sup></li> </ul>
Nën cilën kategori janë të përfshirë të mbijetuarit e DHS-së?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Civilët invalidë të luftës</li> </ul>
Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Civil – invalid i luftës = "një person me dëmtim fizik, prej të paktën 50 për qind, për shkak të plagëve ose lëndimeve që kanë lënë gjurmë të dukshme, dhe që janë shkakuar nga keqtrajtimi ose ndalimi nga armiku gjatë luftës, ose gjatë operacioneve ushtarake, ose të lëndimeve të pësuar nga mbetjet e luftës apo sabotim i armikut, ose nga aktet terroriste".<sup>71</sup></li> </ul>
Kush përjashtohet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viktimat që nuk mund të tregojnë të paktën 50 për qind të dëmtimeve trupore dhe gjurmë të dukshme të lëndimit.<sup>72</sup></li> <li>Ata që nuk kanë dëshmi me shkrim, nga koha kur është kryer krimi<sup>73</sup>, siç janë raportet hetimore.<sup>74</sup></li> <li>Ata që nuk janë shtetas të Serbisë.</li> <li>Të plagosurit në një kohë tjetër përveç periudhës formale të luftës, 24 mars - 26 qershor 1999.<sup>75</sup></li> <li>Ata që janë plagosur jashtë territorit të Serbisë.<sup>76</sup></li> <li>Ata që janë lënduar nga grupet, të cilat nga Serbia, nuk konsiderohen grupe armiqësore.<sup>77</sup></li> </ul>
Përfitimet e reparacioneve	<p>Individuale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përfitime invaliditeti</li> <li>Asistencë për kujdes dhe ndihmë</li> <li>Pajisje ndihmëse ortopedike</li> <li>Rimbursimi i shpenzimeve të varrimit</li> <li>Kujdesi shëndetësor</li> <li>Pagesë e zbritur për transportin publik<sup>78</sup></li> </ul> <p>Kolektive</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përfitimet kolektive për viktimat civile, nuk parashihen me ligj ose me ndonjë akt tjetër ligjor.</li> </ul>
A duhet që të mbijetuarit e DHS-së t'i plotësojnë kushtet për invaliditet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Po</li> </ul>

69 Shënimi më lartë (Supra note) 40, f. 2.

70 Qendra për të Drejtën Humanitare, (2014/2015). Të Drejtat e Viktimave për Reparacione në Serbi dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, f. 14. Në dispozicion në: [http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2016/01/lzvestaj\\_o\\_reparacijama\\_2014\\_eng\\_FF.pdf](http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2016/01/lzvestaj_o_reparacijama_2014_eng_FF.pdf).

71 Ibid., f. 19 duke cituar Nenin 2, Ligji mbi të Drejtat e Invalidëve Civilë të Luftës ("Gazeta Zyrtare e RS-së", Nr. 52/96).

72 Shënimi më lartë (Supra note) 40, f. 5, duke cituar Ligjin për Invalidët Civilë të Luftës, neni 2.

73 Siç është përcaktuar në Nenin 12 të Ligjit.

74 Zotëri Relja Radosavljević, analist ligjor, Qendra për të Drejtën Humanitare, SER, vërejtjet gjatë konferencës konferencës.

75 Shënimi më lartë (Supra note) 72, f. 23.

76 Shënimi më lartë (Supra note) 40, f. 14.

77 Ibid., f. 6.

78 Shënimi më lartë (Supra note) 72, f. 15; Shënimi më lartë (Supra note) 40, f. 22.

Shuma e përfitimit/ve financiare	<p>Shumat e përfitimeve financiare ndryshojnë në varësi të shkallës së invaliditetit dhe llogariten për çdo vit buxhetor.</p> <p>Sipas të dhënave* të siguruara nga Ministria e Punës, Punësimi, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale:</p> <p>Përfitimet personale të invaliditetit ndryshonin nga 79,499 dinarë serbë (RSD) (përafërsisht 720 dollarë amerikanë - USD) për Grupin I të invaliditetit (më e larta) e deri tek 10,335 dinarë serbë (RSD) (përafërsisht 90 dollarë amerikanë - USD) për Grupin VII të invaliditetit (më e ulët).</p> <p>Asistenca për kujdes dhe ndihmë për një person me invaliditet ndryshonte nga 79,499 dinarë serbe (RSD) (përafërsisht 720 dollarë amerikanë - USD) deri tek 36,569 dinarë serbë (330 dollarë amerikanë - USD).</p> <p>*Të dhënat nga Dhjetori i vitit 2015.</p>
Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave të të mbijetuarve <sup>79</sup>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ministria e Punës, Punësimi, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale vendos për ankesa dhe gjithashtu e ka fuqinë, sipas detyrës zyrtare (ex officio), për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të shkallës së parë.<sup>80</sup></li> <li>Vendimet sipas kërkesave për njohjen e statusit të invalidit civil/viktimës së luftës miratohen nga administrata komunale/e qytetit .Ministria e Punës, Punësimi, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale vendos për ankesa dhe gjithashtu e ka fuqinë, sipas detyrës zyrtare (ex officio), për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të shkallës së parë.</li> </ul>
Afatet ose periudha kohore e kufizimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktualisht, sipas legjislacionit të tanishëm, nuk ka asnjë afat kohor. Megjithatë, një afat kohor 10 vjeçar, për kërkesa, është shënuar në projekt ligjin e propozuar<sup>82</sup>, i shoqëruar me një afat të përkohshëm njëvjeçar, për paraqitjen e kërkesave të vjetra, që nga momenti i hyrjes në fuqi të legjislacionit.<sup>83</sup></li> </ul>
Sigurimi i privatësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në legjislacionin aktual nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë lidhur me privatësinë.</li> </ul>

79 Mekanizmi i shqyrtimit të ankesave të të mbijetuarve rregullohet nga dy ligje të tjera. Megjithatë tekstet e tyre nuk janë në dispozicion në gjuhën angleze. Shih Ligjin mbi të Drejtat Themelore të Veteranëve të Luftës, Veteranëve Invalidë dhe Familjeve të Luftëtarëve të Rënë. Në dispozicion këtu: [http://www.osobesainvaliditetom.rs/attachments/023\\_Zakon%20o%20osnovnim%20pravima%20boraca,%20vojnih%20invalida%20i%20porodica%20palih%20boraca.pdf](http://www.osobesainvaliditetom.rs/attachments/023_Zakon%20o%20osnovnim%20pravima%20boraca,%20vojnih%20invalida%20i%20porodica%20palih%20boraca.pdf). Shih gjithashtu Ligjin për të Drejtat e Veteranëve, Veteranëve Invalidë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre. Në dispozicion këtu: [http://www.osobesainvaliditetom.rs/attachments/023\\_Zakon%20o%20pravima%20boraca,%20vojnih%20invalida%20i%20clanova%20njihovih%20porodica.pdf](http://www.osobesainvaliditetom.rs/attachments/023_Zakon%20o%20pravima%20boraca,%20vojnih%20invalida%20i%20clanova%20njihovih%20porodica.pdf)

80 Deklarata e Ministrisë së Punës, Punësimi, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale të Republikës së Serbisë – Asistenca për Viktimat, 1 Dhjetor 2015. Në dispozicion këtu: <http://www.apminebanconvention.org/fileadmin/APMBC/MSP/14MSP/day3/02b-VICTIM-ASSISTANCE-Serbia.pdf>.

81 Ligji Nr. 52/96, për Invalidët Civilë të Luftës ("Gazeta Zyrtare e RS-së", nr. 52/96). Është hartuar një ligj i ri por ende nuk është miratuar. Në dispozicion këtu:

<http://www.minrzs.gov.rs/cir/aktuelno/item/1591-poziv-za-javnu-raspravu-nacr-tzakona-o-pravima-boraca-vojnih-invalida-civilnih-invalida-rata-i-clanova-njihovih-porodica>

82 Neni 140 i Projektligjit për të Drejtat e Veteranëve, Invalidëve Ushtarakë, Invalidëve Civilë të Luftës dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (2015). Në dispozicion (në serbisht) këtu: <http://www.rsjp.gov.rs/misljenja/1205/nac/Zakon%2022.10.2015%20-II.pdf>.

83 Neni 237 i Projektligjit për të Drejtat e Veteranëve, Invalidëve Ushtarakë, Invalidëve Civilë të Luftës dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (2015). Në dispozicion (në serbisht) në: <http://www.rsjp.gov.rs/misljenja/1205/nac/Zakon%2022.10.2015%20-II.pdf>.

## Republika e KROACISË

Ligji/rregullorja për rregullimin e DhSNK-në	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 2015: Akti mbi të Drejtat e Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Agresionit Ushtarak kundër Republikës së Kroacisë në Luftën për Atdheun<sup>84</sup></li> </ul>
Nën cilën kategori janë të përfshirë të mbijetuarit e DHS-së?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Viktimat e dhunës seksuale</li> </ul>
Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dhuna seksuale = pa konsensus ose e detyruar<sup>85</sup> "me depërtim vagjinal, oral ose anal me ndonjë pjesë të trupit ose me një objekt, skllavëria seksuale, aborti i detyruar dhe lëndim serioz me pasojë gjymtimin në tërë ose në një pjesë të organit seksual të një personi".<sup>86</sup></li> </ul>
Kush përjashtohet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ata që nuk janë shtetas kroatë.<sup>87</sup></li> <li>• Ata që në kohën e kryerjes së krimit, ende nuk e kanë filluar procesin e marrjes së leje qëndrimit të përkohshëm në Kroaci.<sup>88</sup></li> <li>• Ata që janë "dënuar për përfshirje në njësitë ushtarake ose paraushtarake të armikut ose për kërcënimin e rendit dhe sigurisë kushtetuese të Republikës së Kroacisë" ose "kanë qenë anëtar, ndihmës ose bashkëpunëtorë të njësive ushtarake apo paraushtarake të armikut".<sup>89</sup></li> </ul>
Përfitimet e reparacioneve	<p>Individuale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një pagesë e vetme prej 100,000-150,000 kuna kroate<sup>90</sup></li> <li>• Një asistencë mujore prej 2500 kuna kroate</li> <li>• Këshillim</li> <li>• Ndihmë ligjore</li> <li>• Ndihmë mjekësore<sup>91</sup></li> <li>• Shërbime rehabilituese<sup>92</sup></li> </ul> <p>Kolektive</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Asnjë</li> </ul>
A duhet që të mbijetuarit e DHS-së t'i plotësojnë kushtet për invaliditet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Jo</li> </ul>
Shuma e përfitimt/eve financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një pagesë e vetme prej 100,000kuna kroate<sup>93</sup></li> <li>• Një asistencë mujore prej 2500 kuna kroate<sup>94</sup></li> </ul>

84 Fondi Global për Gratë, "Kompensimi për mbijetuarit kroatë të dhunës seksuale në konflikt, 20 vjet pas Luftës". Në dispozicion në: <https://www.global-fundforwomen.org/rosa-croatia/>

85 Janine Natalya Clark, "Nga margjinat: Të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë kohës së luftës në Kroaci dhe një analizë e hershme e ligjit të ri", Revista e Praktikave të të Drejtave të Njeriut, (2016) 8 (1): 128-147, Oxford University Press. faqe 11. Në dispozicion në: <http://jhrp.oxfordjournals.org/content/early/2016/03/01/jhuman.huv022.full.pdf>.

86 Ibid.

87 Cyrille Cartier, "Ligji për përdhunimet gjatë luftës në Kroaci ngre shpresë dhe dyshim", Women's News, 23 Korrik 2015 Në dispozicion në: <http://womense-news.org/2015/07/croatias-wartime-rape-law-raises-hope-and-doubt/>.

88 Ibid.

89 Ibid.

90 Shënimi më lartë (Supra note) 87, f. 7.

91 Zoran Radosavljević, "Kroacia e kalon ligjin për të kompensuar viktimat e përdhunimit të luftës", Reuters, 29 Maj 2015. Në dispozicion në: <http://uk.reuters.com/article/uk-croatia-rape-idUKKBN00E1M820150529>.

92 Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Dhunën Seksuale në Konflikt (2015). "Kroacia: Ligji për kompensimin e të mbijetuarve të përdhunimit gjatë kohës së luftës, një hap i mirëpritur në trajtimin e trashëgimisë së dhunës seksuale në konflikt". Njoftim për shtyp, 7 Prill 2015. <http://www.un.org/sexualviolenceinconflict/press-release/croatia-bill-to-compensate-survivors-of-wartime-rape-a-welcome-step-in-addressing-the-legacy-of-sexual-violence-in-conflict/>

93 Shënimi më lartë (Supra note) 93.

94 Ibid.

Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave të të mbijetuarve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbijetuarve, që aplikojnë për përfitime, u kërkohet të plotësojnë një formular ku përshkruhet në detaje dhuna seksuale që përjetuan.<sup>95</sup></li> <li>• Komisioni për Viktimat e Dhunës Seksuale, i cili do të kishte një mandat katërvjeçar, është i ngarkuar me shqyrtimin e informacioneve të paraqitura, për të vendosur, nëse përfituesi i ardhshëm do të marrë përfitime.<sup>96</sup></li> <li>• Më së paku, komisioni duhet të përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm, të cilët duhet të jenë shtetas kroatë, me përvojë të rëndësishme: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një avokat dhe zëvendësi i tij/saj</li> <li>2. Një psikolog dhe zëvendësi i tij/saj</li> <li>3. Një mjek psikiatër dhe zëvendësi i tij/saj</li> <li>4. Një mjek me një specializim tjetër <sup>97</sup></li> </ol> </li> <li>• Përfituesit e mundshëm do të marrin pjesë në procesin e shqyrtimit dhe kanë të drejtë të dëgjohen në mënyrën (a) që ata e preferojnë, dhe (b) që është në përputhje me ndjeshmërinë gjinore.<sup>98</sup></li> </ul>
Afatet ose periudha kohore e kufizimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka përgjigje</li> </ul>
Sigurimi i privatësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka përgjigje</li> </ul>

95 Shënimi më lartë (Supra note) 87, f. 8

96 Ibid.

97 Ibid., f. 7.

98 Ibid., f. 8.



# SFIDAT PËR REPARACIONET

Përkundër që kanë kaluar dy dekada, që nga përfundimi i konflikteve anembanë Ballkanit, vetëm viteve të fundit është bërë përparim i vërtetë, për të mbijetuarit, në hartimin dhe shpërndarjen e programeve të reparacioneve. Gjatë takimit dyditor, pjesëmarrësit theksuan, një numër sfidash të vazhdueshme, në Ballkan dhe më gjerë, për programet e reparacioneve. Këto sfida kryesore përfshijnë:

- **Mungesën e urgjencës, prioritetin e ulët** – Krahasuar me proceset e tjera të pas konfliktit dhe rindërtimit, siç janë Çarmatimi, Demobilizimi dhe Riintegrimi (ÇDR) dhe Reforma në Sektorin e Sigurisë (RSR), reparacionet rrallë herë marrin të njëjtin nivel të vëmendjes, prioritetit, ose të burimeve, pavarësisht potencialit të tyre transformues
- **Mungesën e qasjeve të ndjeshme gjinore**– Mbetet një mungesë e qasjeve të ndjeshme gjinore, kur bëhet fjalë, për reparacionet pas konfliktit. Reparacionet për dhunën seksuale që ndërlihet me konfliktin duhet të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë, duke marrë parasysh dallimin në ndikimin, përvojat, perspektivat dhe nevojat e grave dhe vajzave, si dhe të burrave dhe djemve, të cilët i janë nënshtruar dhunës seksuale.
- **Zhvillimin jo të duhur të kapaciteteve të institucioneve kombëtare rreth reparacioneve**  
Agjencitë ndërkombëtare dështuan që në mënyrë të duhur t'i ndërtojnë kapacitetet dhe sensibilizimin e zyrtarëve kombëtarë, të nxisin shkëmbimet transnacionale, ose të mbështesin planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e reparacioneve në Ballkan. Sipas shumë palëve, kjo ishte një mundësi e humbur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.
- **Financimin e reparacioneve**–Ka mungesë të reparacioneve financiare dhe mbeten pyetje serioze për burimin e financimit të reparacioneve të ardhshme, veçanërisht reparacioneve ndëshkuese të cilat i synojnë autorët individualë.
- **Palët përgjegjëse**–Në Ballkanin Perëndimor ka pasur shumë debate, se cilat qeveri duhet t'i kompensojnë cilët të mbijetuar. Ligjet për reparacionet zakonisht e konsiderojnë përkatesinë etnike, shtetësinë ose vendbanimin e të mbijetuarit ose të kryerësit dhe/ose vendin ku ka ndodhur dhunimi, si kriter i përshtatshmërisë për reparacionet. Kjo është një pengesë për shumë persona, të cilët nuk mund të kërkojnë reparacione sepse dhunimi kundër tyre ka ndodhur përtej kufijve aktualë, ose për shkak se ata nuk janë më shtetas të vendit ku ndodhi krimi.
- **Stigmën**– Stigmatizimi bën që shumë të mbijetuar të frikësohen se “do të zbulohen” nga anëtarët e familjes dhe nga pjesëtarët e komunitetit. Kjo i pengon shumë persona që të avokojnë, ose të flasin hapur për dhunën seksuale, e lëre më të flasin për përvojat e tyre. Ata mund të refuzojnë, të kërkojnë ndihmë ose përfitime të reparacioneve, nëse detyrohen të zbulojnë identitetin e tyre si të mbijetuar të dhunës seksuale, duke penguar avokimin dhe vlerësimet e sakta të numrit të njerëzve të prekur.
- **Qasjen**– Qasja në proceset e reparacioneve mund të jetë e vështirë, nëse këto procese janë të paqarta dhe të vështira për t'u drejtuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për gratë e traumatizuara, që kanë frikë se do të stigmatizohen, dhe të cilat nuk kanë informacione të mjaftueshme për t'i kuptuar proceset e komplikuar burokratike. Gratë e mbijetuar, nga zonat e largëta dhe ato rurale, që e mbajnë barrën e kujdesit për familjet e tyre, të cilave u mungon transporti, dhe që kanë sfida emocionale dhe financiare, ka të ngjarë që të kenë qasje të vështirë.
- **Kapacitetin njerëzor**– Për të mbijetuarit, lufta për drejtësi dhe qasja në përfitime, përgjatë shumë viteve mund të ketë pasoja të thella në shëndetin e tyre mendor dhe fizik. Po ashtu kjo mund t'i dekurajojë ata që punojnë në këtë fushë. Ngopja dhe rënia e fuqisë së njerëzve, të kualifikuar dhe të aftë, mbetet një sfidë dhe mund të ketë pasoja serioze në mbështetjen e punës që tashmë është bërë.
- **Ruajtjen dhe ndërtimin e momentit**– Një pyetje kyçe për pjesëmarrësit nuk ishte vetëm se si të ruhet momenti i tanishëm, por si të punohet mbi të. Në veçanti, ata diskutuan lidhur me mënyrat se si të vazhdohet dhe të rritet avokimi politik, për reparacionet e të mbijetuarve të DhSNK-së në Serbi dhe pjesët e tjera të Ballkanit Perëndimor, të prekura nga konfliktet, ku aktualisht nuk ka legjislacion, si dhe për kontekste të prekura nga konflikti, si në Ukrainë, ku shumë njerëz tani po avokojnë për planifikimin e reparacioneve tani, madje edhe kur vazhdojnë armiqësitë.



### BOX 3

## Paratë kundrejt shërbimeve

Pagesat me para në dorë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një pagesë vetme (edhe nëse është domethënëse) ose për pagesa të vazhdueshme mujore, nuk mund të ofrojnë plotësisht kompensimin për krimin e dhunës seksuale, as nuk mund ta trajtojnë varfërinë e përjetuar nga komunitetet e marginalizuara, pavarësisht nëse këto komunitete janë marginalizuar para shpërthimit të dhunës, ose mund të jenë marginalizuar si pasojë e dhunës. Derisa pagesat me para në dorë janë jetësore për t'i siguruar nevojat e menjëhershme dhe ato afatgjata të të mbijetuarve, të tilla janë edhe shërbimet gjithëpërfshirëse, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, arsimin dhe trajnimin teknik, këshillimin, mbështetjen ligjore dhe aktivitetet e fuqizimit ekonomik. Shërbimet u ndihmojnë të mbijetuarve në garantimin e riintegritit të tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike të komuniteteve të tyre. Kur shërbimet, në mënyrë komplete, i integrojnë nevojat e ndryshme të të mbijetuarve, duke përfshirë krijimin e aftësive dhe arsimimin, kujdesin shëndetësor fizik dhe mbështetjen psiko-sociale, ato kanë potencial të transformohen, jo vetëm për të mbijetuarit, por edhe për familjet dhe komunitetet e tyre.

Për shembull, në Kosovë akterët e shoqërisë civile, të udhëhequr nga gratë, kanë qenë në krye të ofrimit të vetëm këtij lloji të kujdesit gjithëpërfshirës dhe transformues. Medica Kosova, pjesë e Medica Mondiale, i ka mbështetur të mbijetuarit që nga viti 1999, kur menjëherë pas luftës filluan të ofrojnë kujdes shumë të nevojshëm shëndetësor dhe këshillime psikik-sociale për të mbijetuarit. Në vitin 2004, ata e zgjeruan mbështetjen e tyre në krijimin e grupeve të vogla vetë ndihmëse që do t'iu

ndihmonin grave që u shërbenin (kryesisht në zonat rurale) të fitojnë aftësi bujqësore dhe të rivendosin jetën e tyre në mënyrë që të mund të martohen (diçka e rëndësishme për shumë gra në rajon). Medica Kosova siguroi lopë dhe bletë për grupet vetë-ndihmëse, të cilat më pas punuan së bashku për të prodhuar mjaltë, qumësht dhe djathë. Kjo u mundësoi grave të fitonin të ardhura bazë dhe shumë prej tyre raportuan se kujdesi për bletët dhe lopët ishte në vetvete terapeutik dhe kontribuoi në aftësinë e tyre për t'u riintegruar në familjet dhe shoqëritë e tyre. Përveç kësaj, grupet kanë qasje te një avokate që i ndihmon ato t'i zgjidhin çështjet ligjore dhe t'i mbështesin përpjekjet e ndërmjetësimit mes grave, familjeve të tyre dhe gjykatave.

Në BeH, UN Women dhe UNDP po zhvillojnë projekte ekonomike, në mënyrë specifike, për të mbijetuarit e DHSNK-së, të cilat janë të përshtatura për nevojat, burimet dhe preferencat e tyre. Këto projekte i lidhin të mbijetuarit me tregjet ekzistuese, në mënyrë që ata të mund të kenë një burim më të qëndrueshëm të të ardhurave. Të gjithë të mbijetuarit marrin një lloj trajnimi, varësisht nga lloji i biznesit ku ata dëshirojnë të angazhohen dhe këto trajnime gjithmonë shoqërohen me seminare mbështetëse psikik-sociale dhe seanca terapie profesionale. Më së shpeshti bizneset që zhvillohen nga të mbijetuarit jo vetëm që përfundojnë duke punësuar shumë nga anëtarët e familjes së mbijetuarit, por gjithashtu u mundësojnë grave të drejtojnë biznesin dhe të gjenerojnë të ardhura, gjë që simbolikisht është e rëndësishme për statusin e tyre në familje.

# MËNYRA TË REJA TË TË MENDUARIT RRETH REPARACIONEVE: REKOMANDIME PËR AKTERËT KRYESORË

The Takimi ofroi një platformë të fuqishme për diskutime mbi praktikat e mira, mbi atë se çfarë funksionon dhe mbi mënyrat e reja dhe inovative për të konceptuar dhe për t'i dhënë reparacionet për të mbijetuarit. Disa nga rekomandimet e fuqishme specifike, për rajonin e Ballkanit, dolën nga konferenca dy ditore, duke marrë parasysh trashëgiminë e luftës, kulturën e mosndëshkimit dhe hapat e gabuara në të kaluarën. Derisa këto rekomandime janë bërë në kontekstin e konfliktit në ish-Jugosllavi, ka mësim që mund të zbatohen në kontekste të tjera, veçanërisht aty ku sapo ka nisur të mendohet se si mund të mbështetën, më së miri, të mbijetuarit e DhSNK-së.

- Njohja publike e krimit të DHSNK-së është jashtëzakonisht e rëndësishme. Një falje publike zyrtare që njeh llogaridhënien duhet të jetë pjesë e çdo programi të reparacioneve.
- Dhënia fund stigmës dhe rritja e vetëdijes për zgjidhjet në dispozicion është thelbësore për të kërkuar korigjimin e situatës dhe marrjen e mbështetjes.
- Të kuptuarit dhe trajtimi i dimensioneve të ndryshme të traumës është jetik.
- Është thelbësore që të dëgjohen ofruesit e shërbimeve që kanë punuar ngushtë me të mbijetuarit. Ata kanë përvojë dhe zgjidhje krijuese për të bashkëvepruar, me të mbijetuarit, në mjedise të sigurta dhe lehtësuese, dhe janë të pozicionuar, në mënyrë unike, për të ndërtuar lidhje emocionale dhe besim me të mbijetuarit, gjë që shumë më parë i paraprinë diskutimeve mbi programet e reparacioneve.
- Qeveritë dhe OJQ-të duhet të punojnë së bashku për t'ju shërbyer të mbijetuarve dhe për të mbështetur shërimin në komunitet.
- Reparacionet kanë të bëjnë me të mbijetuarit. Ndërsa OSHK-të dhe të tjerët punojnë dhe avokojnë në emër të të mbijetuarve, vetë të mbijetuarit duhet të mbeten në ballë dhe në qendër të të gjitha konsideratave dhe nuk duhet të largohen në sfond.
- Pranimi dhe mbështetja për zgjidhje alternative, deri tek format institucionale të drejtësisë, (p.sh., Gjykata e Grave) është e rëndësishme për t'u lejuar të të mbijetuarve që vetë t'i zgjedhin rrugët e tyre të preferuara të ecjes përpara.
- Të mbijetuarit duhet të angazhohen në planifikimin për të ardhmen dhe jo vetëm të merren me të kaluarën. Shumë të mbijetuar treguan frustrimin se pjesëmarrja e tyre është e kufizuar në përvojat e së kaluarës.
- Veçmas rekomandimeve të mësipërme, janë bërë rekomandime më specifike dhe më përkatëse për praktikuesit dhe politikë-bërësit që merren me DhSNK-në.

## Në Hartimin e programeve të reparacioneve të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe hartimin e legjislacionit adekuat për çështjet gjinore

- Qeveritë duhet të përkushtohen në miratimin e legjislacionit për reparacionet dhe garantimin e zbatimit, përkundër reagimeve negative të publikut.
- Siç e theksojnë dy vendime të rëndësishme gjyqësore në Bosnje, të vitit 2015, proceset e reparacioneve administrative, përveç proceseve gjyqësore penale dhe/ose civile, janë kritike. Në shumë instanca, të mbijetuarit mund të mos e dinë identitetin e kryerësit/ve të krimeve të kryera kundër tyre. Reparacionet administrative e nxjerrin procesin nga sistemi kriminal ose nga gjykata civile, duke u ofruar të të mbijetuarve/ave mundësi për korrigjim.
- Komisionet e shqyrtimit, që vendosin për statusin e të mbijetuarve, si ato që janë ngritur në Kroaci, BeH dhe në Kosovë, duhet të përbëhen nga profesionistë teknikë, duke përfshirë mjekë dhe praktikues të shëndetit mendor, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë ligjorë ose zyrtarë të specializuar të qeverisë.
- Legjislacioni duhet t'ju referohet të mbijetuarve të dhunës seksuale që ndërlidhet me konfliktin dhe jo viktimave ose personave me aftësi të kufizuara.
- Reparacionet janë e drejtë dhe duhet të përshkallëzohen, në bazë të pikëpamjeve të të mbijetuarve individualë ose komuniteteve, dhe jo sipas një vlerësimi subjektiv të aftësisë së kufizuar ose ashpërsisë së krimit.
- Programet e reparacioneve duhet t'i financojnë reparacionet në mënyra inovative, të cilat nuk varen nga aftësia e kryerësit për të paguar. Edhe pse programet e reparacioneve mund të mbështeten përmes financimit ndërkombëtar (kredi dhe grante), qeveritë lokale duhet të mbajnë përgjegjësi financiare dhe ta marrin përsipër drejtimin e tyre nga periudha afatmesme në atë afatgjatë.
- Ata që i planifikojnë programet e

reparacioneve duhet të përpiqen që të sigurojnë, që skemat e reparacioneve të ndihmojnë në krijimin e kohezionit social, dhe të mos shkaktojnë ndarje të reja në komunitete ndërmjet përfituesve dhe jo përfituesve.

- Nuk mjafton vetëm të kalohet legjislacioni për reparacionet. Në vend të kësaj reforma ligjore duhet të ketë gjithashtu fokus në aktet e ndërlidhura nënligjore, gjë që mund të krijojë hapa përshpejtues për zbatimin e plotë ligjor të reparacioneve, duke i përfshirë afatet kohore dhe standardet.
- Për të zbutur politizimin potencial të reparacioneve dhe për të parandaluar traumatizimin dhe stigmatizimin e mëtejshëm të të mbijetuarve/ave, parimi bona fide - i mirëbesimit mund të miratohet në procedurat administrative për reparacione. Kërkesat në mirëbesim (bona fide) kalojnë më shumë përgjegjësi tek komisioni shqyrtues dhe e theksojnë rëndësinë që komisioni të përbëhet nga ekspertë teknikë, me sfond juridik dhe psikologjik, në vend të emërimeve politike.
- Vëmendja dhe angazhimi me mediat është e rëndësishme, për të shpjeguar programet e reparacioneve dhe për të siguruar që nuk po bëhet keqinformim, gjë që lehtë mund të çojë në tensione sociale dhe më shumë stigmatizim për të mbijetuarit/at.

## Destigmatizimi i DhSNK-së në Komunitet:

- Punoni me fëmijët dhe prindërit e të mbijetuarve për të luftuar stigmën e përhapur ndaj të mbijetuarve, gjë që mund të rezultojë në izolimin e tyre nga familjet. Për të mbijetuarit/at mbështetja familjare është kyçe në kapërcimin e frikës, turpmit dhe traumës.
- Angazhohuni me gra dhe burra të moshuar në komunitete, ngase veçanërisht ata, pa dashje mund ta transmetojnë stigmën te brezat e rinj, për shembull, duke iu kundërvënë fëmijëve të tyre që të martohen në familje ku ka të mbijetuar të DhSNK-së.
- Përfshini udhëheqës fetarë të cilët mund të hapin diskutime mbi dhunën seksuale dhe ta dekurajojnë diskriminimin dhe stigmatizimin e të mbijetuarve.
- Përdorni mjete inovative për ta luftuar stigmën dhe turpin, duke përfshirë terapinë artistike, teatrin dhe ekspozitat multimediale.

- Jini të vëmendshëm ndaj gjuhës. Për shembull, mos përdorni fjalë që mund t'i denigrojnë gratë si "të thyera" ose "të dëmtuara" dhe kështu të përforconi stereotipat patriarkalë për gratë dhe trupat e tyre.
- Duhet të njihen identitetet e shumëfishta, në secilin person-të mbijetuarit nuk janë homogjenë. Kur të mbijetuarit njihen vetëm lidhur me përvojën e tyre me dhunën seksuale, kjo i fshin identitetet e tyre të tjera dhe parandalon shërimin, largimin nga trauma dhe stigmatizimi i tyre.

## Angazhimi i Shoqërisë Civile duke përfshirë Punonjësit e Shëndetësisë, Medies, etj.:

- Mbështetni organizatat e grave dhe organizatat e bazuara në komunitet të cilat me aftësi, pajisje, mundësi për avokim dhe financim, janë në ballë të reagimit ndaj DHSNK-së. Avokoni për financim të shoqërisë civile, i cili nuk është afatshkurtër dhe i bazuar në projekte, por që siguron mbështetje për aktivitetet dhe operacionet kryesore të këtyre organizatave.
- Sigurohuni që organizatat e shoqërisë civile të kenë qasjen e domosdoshme, trajnimin dhe ndarjen e informacioneve, duke përfshirë edhe atë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe mekanizmat e tjerë ligjorë ndërkombëtarë, që të monitorojnë dhe të raportojnë për DHSNK-në.
- Pjesëmarrësit në konferencë erdhën edhe nga Qiproja, Turqia dhe Ukraina, ku ose ka konflikt të vazhdueshëm ose ku programet e reparacioneve ende nuk janë zhvilluar. Ata theksuan se për reparacionet që të kenë sukses, qeveritë e tyre, akterët lokalë dhe ndërkombëtarë duhet të kenë një kuptim gjithëpërfshirës të situatës së DHSNK-së në terren. Prandaj, qeveritë duhet të punojnë në partneritet me ofruesit lokal të shërbimeve për të konstatuar dhe dokumentuar nivelet e dhunës seksuale, trendet, objektivat dhe ndikimet, në mënyrë që ata të fillojnë t'i planifikojnë përgjigjet e tyre.

## Rivendosja e Agjencisë së të Mbijetuarve:

- Qeveria, shoqëria civile, hulumtuesit dhe përfaqësuesit prej organizatave ndërkombëtare duhet të jenë të vëmendshëm për angazhimin e të mbijetuarve si të barabartë, t'i dëgjojnë ata dhe t'i hartojnë, së bashku, ndërhyrjet mbështetëse. Një mënyrë për të krijuar marrëdhënie të dobishme reciproke është ofrimi i mbështetjes ose shërbimeve, siç janë sesionet e menaxhimit të stresit.
- Të mbijetuarit duhet të përfshihen në konceptimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e reparacioneve dhe ndërhyrjeve të tjera që u drejtohen atyre, por gjithashtu duhet përpjekur për të lehtësuar lidhje më të mira dhe shkëmbim të ideve mes grupeve të të mbijetuarve, organizatave të grave dhe organizatave të tjera të rëndësishme, për t'i mbështetur të mbijetuarit në role evoluese si agjentë të mundshëm të ndryshimit. Atyre u duhet dhënë mundësia për t'u angazhuar në ndërhyrje dhe aktivitete, të cilat kontribuojnë për të ardhmen e tyre dhe zhvillimin e komunitetit të tyre.
- Gjatë punës me të mbijetuarit, siguria dhe privatësia e tyre duhet të kenë prioritet. Akterët e zhvillimit, hulumtuesit, agjencitë ndërkombëtare dhe organizatat e tjera duhet të lejojnë pezullimin e disa kërkesave (për shembull, kërkesat për listat e emrave, adresave dhe/ose informacione të tjera identifikimi nga pjesëmarrësit ose të pranishmit në ngjarje që synojnë komunikimin ose diskutimin me të mbijetuarit e DHSNK-së) në interes të ofrimit të sigurisë dhe integritetit për të mbijetuarit.<sup>99</sup>

## Trajtimi i Nevojave të Shumëfishta të të Mbijetuarve:

- Reparacionet duhet t'u sigurojnë të mbijetuarve/ave dhe familjeve të tyre, ndihmë shëndetësore dhe mbështetje psikosociale të qasshme, të lirë ose me kosto të ulët, me cilësi të lartë dhe të ndjeshme, si dhe shërbime të tjera siç janë perkujdesja dhe transporti i fëmijëve, në mënyrë që ata t'i tejkalojnë traumat dhe pasojat fizike të DHSNK-së, pasi të mbijetuarit janë duke u plakur, më shumë se njëzet vjet që nga

<sup>99</sup> Për shembull, organizatorët e ngjarjeve duhet të sigurojnë që çdo subjekt juridik, individ ose kushdo tjetër, siç janë përkthyesit, lehtësuesit dhe ofruesit e shërbimeve në vend, e që kanë qasje tek të mbijetuarit, duhet të nënshkruajnë marrëveshje konfidencialiteti. Në të paktën në një rast, vetë të mbijetuesit kërkuar kopje bosh të këtyre marrëveshjeve të konfidencialitetit, për t'i përdorur për angazhime të tjera.

përfundimi i luftërave.

- Të mbijetuarit duhet të fuqizohen për t'u angazhuar në aktivitete ekonomike, përmes trajnimeve profesionale, përfshirjes në udhëzim, qasjes në kredi të vogla, mbështetjes për krijimin e bizneseve dhe bashkimin me rrjete të biznesit.
- Akterët ndërkombëtar të zhvillimit mund të ndihmojnë, në sigurimin e infrastrukturës, për ofrimin efektiv të shërbimeve të riparacioneve dhe të përfshijnë të mbijetuarit e DHSNK-së në zhvillimin dhe zbatimin e përpjekjeve të rehabilitimit/rindërtimit.
- Në kontekstin global të konfliktit sot ka më shumë njerëz të zhvendosur, nga shtëpitë e tyre, sesa në çdo periudhë tjetër në histori. Duke pasur këtë parasysh, riparacionet duhet të hartohen me dispozita të veçanta për personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV), refugjatët dhe refugjatët që kthehen, duke përfshirë mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për risistemim ose kthim dhe programet për integrim ose riintegrim.
- Pjesëmarrësit që vijnë nga jashtë Ballkanit gjithashtu ishin të zëshëm në rekomandimin e tyre, ndaj qeverive, se riparacionet përveçse materiale mund të jenë edhe simbolike. Riparacionet simbolike, si për shembull faljet dhe mirënjohjet publike të profilit të lartë mund të jenë të rëndësishme në procesin kombëtar të shërimit pas konfliktit, si dhe u japin vlerë të mbijetuarve.
- Riparacionet nuk duhet të kombinohen ose të përfshihen në skemat e mbrojtjes sociale, pasi mbrojtjet sociale dhe sistemet e mirëqenies mund të politizohen dhe të ndryshohen tërësisht përmes procesit politik dhe qeverive pasardhëse. Për më tepër lidhja e riparacioneve, me programet e mirëqenies, mund të shërbejë që të mbijetuarit të jenë më pak të fuqishëm, të etiketohen si viktimat pasive që kanë nevojë për bamirësi, sesa të jenë persona aktivë, të cilët janë duke u kompensuar për keqbërjet e kryera ndaj tyre.

## Zhvillimi i Qasjeve Rajonale:

- Të sigurohet që të gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe gjinore, gjatë luftërave në Ballkanin Perëndimor,

të kenë qasje në dëmshpërblime — pavarësisht shtetësisë, rezidencës, dhe vendndodhjes së krimeve që i kanë parë, vendet e rajonit duhet të koordinojnë legjislacionin dhe politikat.

- Të krijohet një fond rajonal i riparacioneve për t'u siguruar që të gjithë të mbijetuarit, pavarësisht se ku ka ndodhur krimi apo shtetësisë së tyre aktuale ose shtetësisë së tyre të dikurshme, t'i gëzojnë të drejtat e tyre për dëmshpërblim. Të ngrihet vetëdija për fondet ekzistuese të mbështetura nga OKB-ja.
- Shumë pjesëmarrës e përshkruan vlerën e shkëmbimit të përvojave në trajtimin e DHSNK-së anëmbanë konteksteve të vendeve të ndryshme. Ata sugjerojnë që qeveritë dhe organizatat rajonale t'i lehtësojnë shkëmbimet rajonale dhe transnacionale, me qëllim të nxitjes së mendimit krijues dhe të mësuarit e praktikave të mira, në hartimin dhe zbatimin e programeve transformuese të riparacioneve.

## Themelimi i Bazës së Provave për Drejtësi:

- Qeveritë dhe akterët e tjerë duhet ta kuptojnë rëndësinë e informacionit dhe grumbullimin e provave nga fazat më të hershme të konfliktit. Për këtë qëllim, qeveritë, akterët vendorë dhe ndërkombëtarë duhet që ta rrisin vetëdijesimin, në mesin e dhënësve të parë të ndihmës dhe ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë punonjësit e policisë, ata të shëndetit mendor dhe fizik, dhe të tjerët, mbi DHSNK-në dhe rëndësinë e dokumentimit të dhunimeve.
- Pjesëmarrësit vërejtën se është me rëndësi kritike për OJQ-të lokale dhe agjencitë ndërkombëtare, që t'i shtyjnë qeveritë kombëtare të veprojnë shpejt, për t'iu përgjigjur pretendimeve të vazhdueshme të abuzimit seksual, si dhe për kërkesat për dëmshpërblim. Përveç kësaj, akterët e shoqërisë civile duhet të avokojnë me anëtarët e Kuvendit dhe vendimmarrësit për të miratuar mekanizma ligjorë, për trajtimin e rasteve të DHSNK-së — nëse nuk ka vullnet politik për të trajtuar DHSNK-në dëshmitë dhe dokumentacioni duhet të mblidhen dhe të dërgohen në organet gjyqësore rajonale ose ndërkombëtare, siç është Gjykata Penale Ndërkombëtare ose Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

# KONKLUZIONI

Marrëveshja e Paqes së Dejtonit u nënshkrua vetëm disa muaj pasi bota u mobilizua, në mbështetje dhe njohje të rolit kritik të grave, në krijimin e paqes përmes miratimit të rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Megjithatë, gratë ishin plotësisht jashtë këtyre negociatave, siç ndodhi më vonë edhe në bisedimet ku u përfshin palët nga Serbia dhe Kosova, para se Kosova të shpallë njëanshëm pavarësinë në vitin 2008. Mungesa e nevojave dhe zërave të grave vazhdon të kumbojë sot. Kjo ishte qartë një mundësi e humbur, të cilën e paguan shtrenjtë të mbijetuarit nga DHSNK-ja.

Në vitet e ndërhyrjeve, që atëherë, individët, akterët e shoqërisë civile, qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare kanë vazhduar të punojnë—nganjëherë në bashkëpunim, kohë pas kohe në mosmarrëveshje — për të ofruar kujdes, shërbime dhe drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Njëzet vjet nga atëherë është shënuar përparim, por shumë më tepër duhet të ndodhë në nivel individual, komuniteti, kombëtar dhe rajonal, për të arritur përmbushjen e të drejtës për reparacion për të mbijetuarit e shumë anembanë rajonit. Kohë pas kohe, pjesëmarrësit nga i gjithë Ballkani dhe jashtë Ballkanit folën për urgjencën e jashtëzakonshme për të krijuar mekanizma të reparacioneve, të cilat janë transformuese dhe që e pranojnë se fuqizimi i grave dhe barazia gjinore e kanë potencialin më të madh për paqe të qëndrueshme dhe zhvillim të drejtë dhe të paanshëm.

Ne e kemi parë se në kaosin, dhimbjen dhe shkatërrimin që e rrethon konfliktin e dhunshëm, është jashtëzakonisht e vështirë për t'i hedhur themelet për riparimin e shoqërisë.

Akterët qeveritarë mund të mos kenë vullnet për të menduar përpara dhe për të parë përtej rindërtimit të infrastrukturës fizike; shoqëria civile dhe organizatat me bazë në komunitet mund të mbulohen nga rritja e kërkesës për shërbimet e tyre; dhe individët shpesh janë shumë të fokusuar thjesht në mbijetesë. Asnjë nga këto nuk e bën shumë të lehtë planifikimin e hershëm për reparacionet—e lërë më të të menduarit për reparacionet transformuese.

Në Ballkanin Perëndimor, ekziston një kuptim i thellë i kohës dhe përpjekjeve që duhen për të kapërcyer përmasat e shumta të traumës. Kjo njohuri dhe përvojë tashmë nevojitet në pjesë të tjera të botës dhe shpresohet se, nëpërmjet përpjekjeve dhe diskutimeve të pjesëmarrësve në këtë konferencë, të tjerët do të mësojnë nga gabimet dhe sukseset këtu, derisa ecin përpara për të rregulluar jetën e të mbijetuarve në konfliktet në tokën e tyre.



## REFERENCAT

Sekretariati i Amnesty International (2009). Bosnja dhe Hercegovina: 'Drejtësia e kujt?': Gratë e Bosnjës dhe Hercegovinës janë ende në pritje. Në dispozicion në: <https://www.amnesty.org/en/documents/EUR63/006/2009/en/>.

Bartlett, Uilliam (2013). Analiza e mangësive në fushën e politikave të mbrojtjes sociale dhe përfshirjes në Bosnjë dhe Hercegovinë, UNICEF. Në dispozicion në: <http://www.unicef.org/bih/GAPanalysis-1.pdf>.

Cartiet, Cyrille (2015). Croatia's Wartime Rape Law Raises Hope and Doubt. Women's ENews, 23 July. Në dispozicion në: <http://womensenews.org/2015/07/croatias-wartime-rape-law-raises-hope-and-doubt/>.

Clark, Janine Natalya (2016). Nga Margjinat: Të Mbijetuarat/it e dhunës seksuale në Kroaci dhe një Analizë e hershme e Ligjit të ri. Gazeta e Praktikës së të Drejtave të Njeriut (2016) 8 (1): 128-147. Shtypi i Universitetit Oxford. Në dispozicion në: <http://jhrp.oxfordjournals.org/content/early/2016/03/01/jhuman.huv022.full.pdf>.

Gaijin, Saša, ed. (2015). Ligji Model për të drejtat e viktimave civile të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera gjatë, apo të ndërlidhura me, konfliktet e armatosura në Periudhën 1991-2001. Në dispozicion në: [https://issuu.com/dhrpraxis/docs/model\\_law\\_of\\_the\\_rights\\_of\\_civilian](https://issuu.com/dhrpraxis/docs/model_law_of_the_rights_of_civilian).

Fondi Global për Gratë. Kompensimi për të mbijetuarat/it kroatë të dhunës seksuale në konflikt, 20 vjet pas Luftës. Në dispozicion në: <https://www.globalfundforwomen.org/rosa-croatia/>

Qendra për të Drejtën Humanitare (2004). Reparacionet administrative në Serbi - Një analizë e kuadrit ekzistues ligjor. Në dispozicion në: [http://www.hlcrdc.org/wpcontent/uploads/2014/03/Administrative\\_reparations\\_in\\_Serbia\\_an\\_analysis\\_of\\_the\\_existing\\_legal\\_framework.pdf](http://www.hlcrdc.org/wpcontent/uploads/2014/03/Administrative_reparations_in_Serbia_an_analysis_of_the_existing_legal_framework.pdf).

Qendra për të Drejtën Humanitare, (2014/2015). E drejta e viktimave për reparacion në Serbi dhe Standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në dispozicion në: [http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2016/01/Izvestaj\\_o\\_reparacijama\\_2014\\_eng\\_FF.pdf](http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2016/01/Izvestaj_o_reparacijama_2014_eng_FF.pdf)

Komisioni ndërkombëtar për personat e zhdukur, Instituti për personat e zhdukur në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Qendra për qasje të lirë në informata (2007). Udhëzuesi për viktimat civile të luftës: Si të gëzojmë të drejtën për mbrojtje si viktimë civile e luftës në Republikën Serbe. Në dispozicion në: <http://www.icmp.int/wp-content/uploads/2014/08/guidebook-wictim-of-war-rs.pdf>.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë Tranzicionale. Çka është Drejtësia Tranzicionale? Në dispozicion në: <https://www.ictj.org/about/transitional-justice>

Malkić, A. dhe Tea Hadžiristić (2016). Ndërlidhja e pabarazive në mbrojtjen sociale në Bosnjë dhe Hercegovinë: Rezultatet e një studimi empirik. ANALITIKA Qendra për kërkime Sociale. Në dispozicion në: [http://www.analitika.ba/sites/default/files/inequality\\_eng\\_-\\_izvestaj\\_2403.pdf](http://www.analitika.ba/sites/default/files/inequality_eng_-_izvestaj_2403.pdf).

Ministria e punës, punësimit, veteranëve dhe çështjeve sociale të Republikës së Serbisë – Ndihmë për Viktimat (2015). Deklaratë. Dhjetor. Në dispozicion në: <http://www.apminebanconvention.org/fileadmin/APMBC/MSP/14MSP/day3/02b-VICTIM-ASSISTANCE-Serbia.pdf>.

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (2005). Parimet themelore dhe udhëzimet mbi të drejtën për rimëkëmbje dhe reparacion të viktimave të shkeljeve të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar. Në dispozicion në: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx>

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (2011). Mbrojtja Ligjore Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut në Konfliktet e Armatosura. Në dispozicion në: [http://www.ohchr.org/Documents/Publications/HR\\_in\\_armed\\_conflict.pdf](http://www.ohchr.org/Documents/Publications/HR_in_armed_conflict.pdf)

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (2014). Udhëzuesi i Sekretarit të Përgjithshëm:

Reparacionet për Dhunën seksuale gjatë konfliktit, qershor. Në dispozicion në: <http://www.ohchr.org/Documents/Press/GuidanceNoteReparationsJune-2014.pdf>

Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Dhunën seksuale gjatë konfliktit (2015). Kroaci: Fatura për kompensimin e të mbijetuarve/ave të përdhunimit gjatë luftës një hap mirëprirës në trajtimin e trashëgimisë së dhunës seksuale gjatë konfliktit. Njoftim për shtyp, 7 prill. Në dispozicion në: <http://www.un.org/sexualviolenceinconflict/press-release/croatia-bill-to-compensate-survivors-of-wartime-rape-a-welcome-step-in-addressing-the-legacy-of-sexual-violence-in-conflict/>

Kroacia miraton ligjin për kompensimin e viktimave të përdhunimit të luftës. Reuters, 29 maj. Në dispozicion në: <http://uk.reuters.com/article/uk-croatia-rape-idUKKBN0OE1M820150529>.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (2014). Raporti i Raportuesit special për promovimin e të vërtetës, drejtësisë, reparacionit dhe garancive të mos-përsëritjes, tetor. Në dispozicion në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N14/564/67/PDF/N1456467.pdf?OpenElement>

Organizata e Kombeve të Bashkuara (2015). Raport i Grupit këshillues të ekspertëve për shqyrtimin e Arkitekturës së ndërtimit të paqes të Kombeve të Bashkuara të vitit 2015. Në dispozicion në: <http://www.un.org/en/peacebuilding/pdf/150630%20Report%20of%20the%20AGE%20on%20the%202015%20Peacebuilding%20Review%20FINAL.pdf>

Organizata e Kombeve të Bashkuara (2016). Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën seksuale në konflikt. 20 Prill. Në dispozicion në: [https://unama.unmissions.org/sites/default/files/20042016\\_report\\_of\\_the\\_secretary-general\\_on\\_conflict-related\\_sexual\\_violence.pdf](https://unama.unmissions.org/sites/default/files/20042016_report_of_the_secretary-general_on_conflict-related_sexual_violence.pdf)

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (2013). Vlerësimi i numrit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në territorin e Republikës së Kroacisë dhe Formave optimale të kompensimit dhe mbështetjes së viktimave. Zagreb. Në dispozicion në: <http://www.hr.undp.org/content/dam/croatia/docs/Research%20and%20publications/socialinclusion/UNDP-HR-SEXUAL%20-VIOLENCE%20-IN%20-CONFLICT-RESEARCH-ENG-2014.pdf>

UN Women (2016). Së shpejti Reparacionet për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale në Kosovë. 15 mars. Në dispozicion në: <http://eca.unwomen.org/en/news/stories/2016/03/kosovo--new-regulation-sexual-violence>.



**UN WOMEN ËSHTË ORGANIZATA E  
KOMBEVE TË BASHKUARA, PUNA E SË  
CILËS I DEDIKOHET BARAZISË GJINORE  
DHE FUQIZIMIT TË GRAVE. NJË KAMPION  
GLOBAL PËR GRATË DHE VAJZAT,  
UN WOMEN ËSHTË THEMELUAR PËR TË  
PËRSHPEJTUAR PROGRESIN DREJT  
PLOTËSIMIT TË NEVOJAVE TË TYRE NË MBARË  
BOTËN.**

UN Women përkrah shtetet anëtare të OKB-së përdorin ato vendosin standardet globale për arritjen e barazisë gjinore, dhe punon me qeveritë dhe shoqërinë civile për të hartuar ligjet, politikat, programet dhe shërbimet e nevojshme për zbatimin e këtyre standardeve. UN Women mbështet pjesëmarrjen e barabartë të grave në të gjitha aspektet e jetës, duke u përqëndruar në pesë fusha prioritare: rritja e udhëheqjes dhe pjesëmarrjes së grave; dhënia fund dhunës ndaj grave; angazhimi i grave në të gjitha aspektet e proceseve të paqes dhe sigurisë; fuqizimi i mëtutjeshëm ekonomik i grave; dhe bërja e çështjes së barazisë gjinore një çështje kyçe në planifikimin dhe buxhetimin e zhvillimit kombëtar. UN Women gjithashtu bashkërendon dhe nxit punën e sistemit të OKB-së në avancimin e barazisë gjinore.



UN Women zyrja në Kosovë  
rr. Hyzri Talla 26/1  
10000 Prishtinë  
Kosovë

Tel: +381 38 554 645  
[www.unwomen.org](http://www.unwomen.org)  
[www.facebook.com/unwomen](https://www.facebook.com/unwomen)  
[www.twitter.com/un\\_women](https://www.twitter.com/un_women)